



# Dukagjini

**Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XV i botimit, nr. 160, Shkurt 2017**

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

*100 vjet arsim dhe kulturë në Dukagjin*

## NDER DHE RESPEKT PER POPULLIN E TEMAL DUSHMANI 2


- Kujtime -

Njerëzit më të mirë të botës për mua, më të shtrenjëtit, më fisnikët, që shpirti i tyre është humanizëm, besë e mikpritje. Më 3 maj 1976 jam larguar nga gjiri i tyre, pra mbi 40 vjet. Edhe 400 vjet me e pasë jetën time nuk i harroj sepse aty pashë jetesën shumë të vështirë, por sofra e bujarisë ma e bardhë se bora e Cukalit. Aty pashë besnikërinë taman të shqiptarit të vërtetë (si te Konstandini për të motrën). Aty pashë kthjedhtësinë e mendimeve të kristalta si uji i krojeve të tyre, aty gjeta dashurinë për dritën (më shumë se i verbëri për diellin) dhe diturinë. Duke bërë analizë dhe sintezën e kolosit, viganit dhe eruditit të madh Martin Camaj nga Teluma meditoj dhe bindi vetëveten se këtu është forca e dashurisë për dijes dhe tabanin e tokës, siç shquhet shqiptari për nderën, besën, mikun dhe humanizmin.

## Lazër Stani: Dritëroi, poet i tokës dhe i shpirtit shqiptar 6

Fillimisht do të donim të dinim, si e keni njohur Dritëro Agollin?

Fillimisht e kam njohur nga poezitë, si lexues që kur isha nxënës shkolle, siç e kanë njohur shumica e shqiptarëve. Mbjaj mend, pas shkollës së mesme, kur po bëja stazhin, u botua një libër me poezi të zgjedhura të Dritëroit, me kopertina blu. Atë libër e kam mbajtur shumë kohë në dorë dhe disa vargje lirike të botuara në atë libër i mbaj mend



## VLERËSIME 3 MËRËNJOHJE PËR PUNËN E BËRËNË ARSIMNGA ISH MËSUES DUKAGJINAS, QË NUK JETOJNË

Arsimi në Dukagjin pati arritje të mëdha sidomos para viteve 90, si në anën cilësore ashtu edhe atë sasimore. Padyshim që rolin determinant e kishte mësuesi me përkushtimin e tij për të kryer misionin e shenjtë që ai kishte për pajisjen me dije dhe edukimin e brezave të rinj. Mësuesit gëzonin respekt, sepse mbartnin fisnikëri në çdo fjalë e veprim. Ishin misionarë të dijes e moralit, këshilltar i të mirës e progresistes, fanar ndriçues, siç e cilësoni, për çfarë jepte e si e vlerësonin ku rrezatonin në çdo hap kulturë, aftësi komunikuese e profesionale.

## MËSHUMËSE NJË URIM PËR DATËLINDJE, 50 VJETORI I ZEF GJEDËS 4



Jo shpesh në gazeta dhe në media vizive, shkruhet dhe flitet për persona apo personalitete të ditëve tona që kanë një qasje pozitive ose e përmbledhur; janë intelektuale të vërtetë evropian. Një jetë e trazuar në politikë, një ekonomi e pa stabilizuar me një varfëri të madhe, një mjedis shoqëror me kriminalitet - pra në ditët tona më shumë në medime dalin njerëz negativ, të cilët i urren, nuk të mbetët gjë në kujtesë për të mirë...

## 100 vjet arsim dhe kulturë në Dukagjin

# NDER DHE RESPEKT PER POPULLIN E TEMAL DUSHMANI

- Kujtime -

Njerëzit më të mirë të botës për mua, më të shtrenjëtit, më fisnikët, që shpirti i tyre është humanizëm, besë e mikpritje.

Më 3 maj 1976 jam larguar nga gjiri i tyre, pra mbi 40 vjet. Edhe 400 vjet me e pasë jetën time nuk i harroj sepse aty pashë jetesën shumë të vështirë, por sofrë e bujarisë ma e bardhë se bora e Cukalit. Aty pashë besnikërinë taman të shqiptarit të vërtetë (si te Konstandini për të motrën). Aty pashë kthjedhtësinë e mendimeve të kristalta si uji i krojeve të tyre, aty gjeta dashurinë për dritën (më shumë se i verbëri për diellin) dhe diturinë. Duke bërë analizë dhe sintezën e kolosit, viganit dhe eruditit të madh Martin Camaj nga Teluma meditoj dhe bindi vetëveten se këtu është forca e dashurisë për dijes dhe tabanin e tokës, siç shquhet shqiptari për nderën, besën, mikun dhe humanizmin.

Thashë kanë kaluar 40 vjet, por shoqëria e mirë, kujtimet dhe mbresat e të gjithë shokëve e shoqeve që punuam me ndërgjegje e sieder burrërore, arritëm të realizonim në rritje dhe cilësi të gjitha detyrat që i dilnin shkollës, ne mësuesve, që ajo kohë e atyre viteve na quante "Komisarë të Dritës".

Impenjim total i të gjithë shoqërisë dhe shtetit për dijen dhe kulturën, masivizimin e të gjithëve, cilësinë e përvetësimit sa më të mirë të dijes dhe lidhjen e saj me jetën. Terreni, gjendja ekonomike, baza materiale, gjeografia e fshatrave, të gjitha këto ishin barriera të forta që duheshin mposhte, kapërcyer dhe arritur objektivat.

Po ku bëhëj kjo luftë?

Në të gjithë shoqërinë, por unë me përgjegjësi intelektuale dhe ndërgjegje do të transmetoj në këto rreshta periudhën 1 shtator 1969 deri më 3 maj 1976, ato që pashë me sy, preka me dorë dhe dëgjova me veshë për periudhën para se unë të punoja atje për çfarë është punuar atje, në atë zonë.

Sapo ishte formuar kooperativa bujqësore dhe Teluma ishte caktuar si qendër e sektorit. Jo se kishte banorë shumë por ishte si një qëndër e rrethit me pika të barazlanguara nga qendra. Në këtë sektor bënin pjesë fshatrat Malagji, Kajvall, Klllogjën, Teluma, Vila. Teluma kishte 16 shtëpi. Nga shtëpia e parë deri te e fundit, vetëm në këmbë mund të bëhej lëvizja, duheshin dy orë e gjysmë. Merreni me mend lëvizjen për në fshatrat e tjerë të këtij sektori. Vendosija e qendrës së sektorit në këtë vend që vendositi e quanin "Krye Sukës", në lartësinë rreth 1000 m mbi nivelin e detit ishte bërë për të qenë sa më në qendër të sektorit. Këtu u ngrit sektori, shkolla 8 vjeçare nga klasa e V-VIII, filloret ishin larg e shumë larg.

Këtu u ndërtuan zyrat e sektorit, furrë buke, mulli, rrobaqepësi, ambulacë ku shërbente infermieri, rrjeti i tregëtisë me artikuj të përzier, depo armatimi e kohës për forcat vullnetare të zonës, centrali telefonik që lishte të gjitha fshatrat e Temal Dushmanit.

Në pikpamjen administrative shtetërore këto fshatra grupoheshin në tri këshilla popullore të fshatrave bazë: 1- Vila, 2- Malagji-Kajvall, 3- Telumë-Klllogjën. Kishë Arra (Arrza pas 1967) kishte këshillin e fshatit në vete, shkollën 8 vjeçare. Drejtor shkollë u caktua Xhevdet Shima nga Melgusha dhe mësues ishin Sami Spahija nga Shkodra, Njac Luan nga Beltoja, Zharko Camiq dhe Refik Leka nga Vraka për 8 vjeçaren, ndërsa për filloren ishte mësues Zef Kini vendali dhe në Kishë Arrë, Brahim Shega nga Oblika. Pavarësisht se Kisha Arra administrativisht quhej Arrëz, banorët dhe ne thonim në Katund të Kishës. Kisha, pas vitit 1967 u kthye në shkollë 8 vjeçare e objekte të tjera sociale.

Shkolla 8 vjeçare u hap me 1.9.1969, ndërsa fillorja nuk e di kur është hap, nuk kam të dhëna, por kam dëgjuar se mësues në Kishë Arra kanë qenë Kin Mhilli vendas, pastaj Gjon Podja.

Kjo zonë ishte shumë e hapur nga Mali i Cukalit, Guri i Lekës, Molla e Shoshit, Toplana që përshkohen nga Lumi i Shalës, Drini e ndanë nga Puka. Në këtë zonë asnjë familje nuk prodhonte bukën për të gjithë vitin, për shkak të mungesës së tokës së puneshme që ishte e pakët dhe pjerrësisë së madhe të saj. Buka prodhohej vetëm për pak muaj.

Në këtë terren ekzistonte ky sektor që përfshihej në koop. bujq. të Shllakut, territor i paimagjinueshëm për nga shtrirja e relievit, që kishte 5 shkolla 8 vjeçare që ishin: Barcolla, Kodër Nikaj, Palaj-Gushtë, Telumë dhe Vilë. Shkolla fillore të veçanta ishin: Thepi, Zbuqi, Kroni i Madh, Palaj, Benë, Kantjeri i Cukalit, Qerret, Kanas, Malagji, Kajvall, Klllogjën, Arrë. Në mënyrë të përmbledhur në Shllak ka pasur 5 shkolla 8 vjeçare dhe 12 shkolla fillore të veçantë (jo në të njëjtin vend ku ishin edhe 8 vjeçaret). Kodër Nikaj apo siç thuhet ndryshe Logu i Gegajve, ishte qendra e krahinës së Shllakut. Këtu ishte drejtor shkollë Zef Deda, ish deputet në Kuvendin Popullor të Shqipërisë, i cili mbulonte tërë karhinën për shkollën por edhe Shoshin e Shllakun si deputet.

Unë kujtoj këta mësues sipas shkollave në Shllak:

Barcollë:

Ferit Kamberi, Tomazin Deda, Ruzhdi Anamali, Mustafë ?, Namik Kruja, Lodovik Deda.

Palaj-Gushtë:

Nuk kujtoj vetëm katër mësues sepse ishte distancë shumë e largët dhe nuk kishim kontakte: Pal Qafa, Ndoc Gjini, Haki Spahija, Rrok Jaku.

Kodër Nikaj:

Elez Bushati, Muhamet Kastrati, Agim Kapisyzi, Murzak Karagjozi, Xhevdet Lada, Ollga?

Vila, aneks i shkollës tetëvjeçare Telumë:

Ndoc Keqi, Ali Brahusa, Rexhep Dedushi, Man Mataj, Nuk Broja, Sherif Kurti, Prishtik Morina, Tahir Myftia.

Telumë, me 1.9.1968 është hapur shkolla 8 vjeçare:

Ali Brahusa Drejtor, që u zëvendësua nga Shemsi Sovali dhe ky nga unë Ruzhdi Poda, Agostin Shuku për matematikë fizikë, Elizabeta Bushati biologji-kimi, Antoneta Gjini gjuhë-letërsi, Qazim Tahircu, të cilin e gjeta në Kanas me 11 nxënës me katër klasa kolektive, të cilët po i shoqëroj me foton e tyre të 46 vjetëve më parë Pastaj kanë ardhur edhe të tjerë në vitet më vonë, Sait Hasani, Sali Bushi, Prenda Luli, me xhaxhanë e saj Nosh Luli, Harap Ograja, Gjovalin Curri, Fatmira Ulqinaku, Gëzim Kastrati, Gaspër Linadi, Eqerem Hyseni, Rrok Fusha, Zija Barbulushi, Gjergj Dodani, Zef Noshi, Marie Fusha, Dila Toka, File Marashi, Mediha Hoxha, Smajl Qershia, Ali Cani, Eqerem Hyseni, Dedë Mojsiu. Me siguri se në këtë zonë kanë punuar edhe mësues të tjerë, por me keqardhje nuk i kujtoj, veçanërisht ata që kanë punuar para se me shkue unë atje dhe pasi jam larguar, por gjithsesi ju kërktoj të falur që nuk pata mundësi që ti përmendë.

Unë isha pa arsim përkatës dhe pothuaj jashtë profilin, por na vunë detyrë që të vazhdonim me korespondencë. Në vitin 1973 transferohet drejtori Shemsi Sovali dhe më emruan mua në këtë detyrë.

Periudhën më të gjatë në shkollën 8 vjeçare Telumë ka punuar Nosh Nikollë Luli nga Mali Kolaj të Velipojës. Më 1976 më zëvendësoi mua në detyrën e drejtorit, pasi unë me vendim të këshillit të rrethit u emrova në Hidrocentralin e Fierzës.

E para, pra "A"-ja e punës ishte frekuentimi i nxënësve në shkollë në arsimin e detyruar deri në moshën 16 vjeç me çdo kusht. Falë dashmirisë për dije e arsim, ndihmës së organeve shtetërore vendore të kohës, asnjëherë frekuentimi nuk e patëm problem. Po kujtoj një gjë të veçantë për dy nxënës vëllezër dhe një të afërm të tyre në Siraç, në afërsi të majës së Cukalit. Distanca nga shkolla më e afërt ishte rreth 3 orë. Për të shkuar në Vilë duhej të kapërcenin lumin e Vilës, i cili tërë vjeshtën dhe pranverën ishte i mbushur me ujë, ndërsa verës shteronte fare, por edhe shkolla mbydhej. Si drejtor e bej problem në seksionin e arsimit dhe zgjidhja u arrit që të paguhej me sistem gjashtë orësh. Gjeta mbështetje nga Burbuqe Mandija që ishte shefe e seksionit të arsimit si dhe të Kolec Biba, Muamer Vuci, Lec Zadeja, Islam Dizdari. Këta vendosën për arsimimin e këtyre nxënësve me një

vendim të veçantë. Mësuesi Brahim Shega pas dreke bënte mësim me këta tre nxënës. Njëri nga këta arrinë të mbarojë studimet e larta me nota shumë të mira, Universitetin Bujqësor në Tiranë. Sapo erdhi demokracia u zgjoll për shumë vite kryetar i Komunës në Temalit me qendër në Koman.

Boshti i punës tonë, përjashto politizimin, ishte cilësia mësimore, nota mesatare e nxënësit, klasës e shkollës sipas lëndëve. Ky motivim na mbante të karruar e të lidhur ngushtë e sistematikisht me punën e cila na nxiste që secili nga ne të bënte një gjë të mirë për të rritur cilësinë dhe notën mesatare, të arrijmë rezultate sa më të larta, të dalin klasa, shkolla apo zona më e mirë, pra rritej seditra pozitive tek secili, që atëherë thuhej ambicja revolucionare.

Në atë kohë viti shkollor ndahej në tre semestra, i pari fillonte në shtator dhe mbydhej me 28 dhjetor, i dyti fillonte me 12 janar dhe mbydhej me 30 mars, ndërsa i treti fillonte me 6 prill dhe mbaronte në fund të vitit shkollor. Provimet e lirimit zhvilloheshin në qershor me masa organizative shumë të rrepta dhe me praninë e përfaqësuesve të seksionit të arsimit të rrethit.

Punë të kujdesshme në shkollë bënte edhe organizata profesionale për të gjitha punët në shkollë. Vetë unë kam filluar punën në arsim me arsim 7 vjeçar të kohës, ndërsa në vitin 1978 jam me arsim të lartë. Në pesë shkollat që mbyllonte drejtorja jonë është bërë një punë e madhe për shkëmbimin e prevojës së përparuar. Edhe sot kam fletoren e nxënësit Lulash Pashuk Zefi në klasën e parë në Kanas me shkrimin e tij me mësues Brahim Shega.


Edhe sot ndjej kënaqësi të veçantë për punën e mirë që kemi bërë si staf mësuesish dhe i përhëndes dhe i falnderoj ata dhe të gjitha banorët e Temal-Dushmanit në realizimin e misionit fisnik ndaj shoqërisë dhe atdheut. Falnderoj me gjithë shpirtë popullin e Temal-Dushmanit. Jam krenar që nga këto shkolla u arsimuan duke rrokur të tëra profilet e nevojshme për zonën, por edhe më gjërë, si Mjeku Paulin Ndue Darçaj, Agronom Mark Xhuri e Mark Molla, teknik avionësh Gjelo Kola, ekonomist Dosh Brushtulli, Ndue Molla, infermiere-mami Lula Mhilli e Tone Mhill Çaranishti, mësues dhe drejtues shkollë si Kin Kola, Nikollë Brushtulli, Pjetër Zymeri, File Marashi, Lulash Molla, Tomë Brushtulli, merceologji Ndue Rrasa, Dedë Guri, etj, etj. që nuk po më kujtohen.

Vijon në numrin e ardhshëm

**RUZHDI PODA**

Ish mësues dhe drejtor shkollë në Temal-Dushman

# VLERËSIMET MËRËNJOHJE PËR PUNËN E BËRËNË ARSIMINGA ISHMËSUES DUKAGJINAS, QË NUK JETOJNË



Arsimi në Dukagjin pati arritje të mëdha sidomos para viteve 90, si në anën cilësore ashtu edhe atë sasiore. Padyshim që rolin determinant e kishte mësuesi me përkushtimin e tij për të kryer misionin e shenjtë që ai kishte për pajisjen me dije dhe edukimin e brezave të rinj. Mësuesit gëzonin respekt, sepse mbartnin fisnikëri në çdo fjalë e veprim. Ishin misionarë të dijes e moralit, këshilltar i të mirës e progresistes, fanar ndriçues, siç e cilësoni, për çfarë jepte e si e vlerësonin ku rrezatonin në çdo hap kulturë, aftësi komunikuese e profesionale. Prandaj, edhe pse një pjesë e tyre nuk jetojnë vlerësohet puna e tyre dhe u jemi mirënjohës për çfarë kanë bërë për konsolidimin e shkollës dhe kujtohen me shumë respekt jo vetëm çdo 7 Mars por, edhe gjatë çdo viti mësimor, sepse kanë mbetur në memorien tonë. Koha e shërbimit në arsim e tyre është e ndryshme. Disa kanë dalë në pension në arsim, disave u është ndërprerë jeta në moshë të re dhe disa janë larguar nga arsimi duke kaluar në sektorë të tjerë, por të gjithëve u duhet vlerësuar puna.

Sigurisht do të përmendim ata që kanë jetuar e punuar në atë territor të Dukagjinit, banorët e të cilët e quajnë për krenari se janë dukagjinas.

**Prel Bregu** – nga Breglumi, Shalë. I pari agronom me arsim të lartë. Mbas kontribuoi si specialist disa vite në ekonominë bujqësore, kaloi si mësues në shkollën e mesme bujqësore në Breglumi, ku kontributi i tij për konsolidimin e kësaj shkolle ishte i madh si në pajisjen e nxënësve me dije shkencore e sidomos në lidhjen e teorisë me praktikën. Ishte hokatar i lindur, gazmor dhe me aftësi të rralla komunikuese me çdo kategori njerëzish, i cili kishte fituar respektin e tyre. U bë i pazëvendësueshëm që nga 7 Marsi i 1990-ës.

**Lazër Fusha** – Breglumi. Me arsim të lartë në Histori - Gjeografi. Ishte modeli i mësuesit e drejtuesit korrekt, i përkushtuar në shkallën sipërore për të kryer çdo detyrë që i ngarkohej. Këtë e shfaqti kudo ku punoi si drejtor zone në Shosh, drej-

tor shkolle në Abat e mësues në Theth, Ndërllysaj, Lotaj e Breglumi.

**Ndue Ndrezaq** – Vuksanaj. Me arsim të lartë Bio - kimi. Shumë gjurmëlënës kudo ku punoi si mësues e drejtor shkolle në Vuksanaj e Breglumi dhe vitet e fundit të jetës, në Gomsiqe.

**Fran Dardha** – Abat. Me arsim të lartë Matematikë - Fizikë. Shumë korrekt e i aftë në punë. E filloi punën në Toplanë drejtor shkolle pastaj në Vuksanaj, Abat e Breglumi, ku në këtë të fundit shumë vite drejtor konvikti. Ishte shumë praktik.

**Mhill Leka** – Kodërshëngjergj. Shumë punëtor kudo ku punoi si në Shosh dhe shumë dekada në Lotaj. Nuk dinte ti shmangej punës. Fati e deshi që jetonte edhe shumë vite në pension.

**Prek Vuksani** – Ndrejaj, Shosh. Mësues me horizont të gjerë sepse ishte shumë studios. Këtë e pasqyrore në përmeshjen e misionit si mësues e drejtues shkolle kudo ku punoi si në Toplanë, fshatrat e Shoshit, sidomos Brashtë e Ndrejaj, ku shërbeu disa dekada drejtor shkolle.

**Pjetër Selimi** – Kir. Me arsim të lartë Matematikë. E karakterizonte thjeshtësia dhe alegria. Nuk dinte të nevrkosej dhe çdo punë në arsim e bënte mirë si ai duke qeshur si mësues e drejtor shkolle në Kir apo Inspektor arsimi për zonat malore. U nda nga jeta shume shpejt, në një kohë kur arsimi kishte shumë nevojë për të.

**Ndue Bregu** – Breglumi. Përveç mësimdhënës i pasionuar në shumë shkolla të Shalës dhe Kastratit, ai ishte shumë aktiv në sektorin e kulturës si krijues këngësh e interpretues. Ishte një vjershëtor i talentuar.

**Prenda Pjetri (Lekçaj)** - Vuksanaj, e martuar në Lotaj. Ndër mësueset e para e mirë arsimuar nga Dukagjini. Mbas fillimeve të para në Breglumi, për shumë dekada punoi në qytetin e Pukës si mësuese e drejtoreshë konvikti, e cila me punën e saj fitoi respektin e të gjithëve.

**Shkurte Rusheta (ARA)** – Lekaj. Kudo ku punoi në Breglumi e Kopluk të flasin fjalët më të mira, e cila nuk ishte thjesht mësimdhënëse, ku puna nuk i bënte vaj, por ishte edhe aktive në veprimtaritë kulturore dhe aktiviste shoqërore.

**Dedë Mbrapshtia** – Gimaj. Me arsim të lartë Histori - Gjeografi. Ka qenë shumë vite drejtor shkolle në Plan, Ndrejaj-Shosh e Gimaj duke treguar aftësi menaxhuese e mësimdhënies. E mbylli jetën tragjikisht në moshë të re duke lënë mbrapa respektin e atyre që e njohën për punën e sjelljen e tij.

**Fran Beka** – Lekaj, Shalë. Është vlerësuar maksimalisht për punën e tij si mësimdhënës dhe aktivist shoqëror. Ishte shumë i përgatitur profesionalisht tek i cili ishin të gërsheutara mjaft mirë vetitë më pozitive të edukatorit.

**Violeta Dardha (Zylo)** – Abat, Shalë. Me arsim të lartë. E filloi punën në

vendlindje, e vazhdoi në qytetin e Shkodrës dhe shumë vite në Tiranë derisa u nda nga jeta në moshë të re. shumë e përkushtuar për të justifikuar misionin e shenjtë që mësuesi ka.

**Prek Sokoli** – Lekaj. Me arsim të lartë. Shumë kontribuues që nga zhdukja e analfabetizmit, e konsolidimin e arsimit bazë në Dukagjin e deri drejtues i shkollës së mesme të ndërtimit në Shkodër. Është shumë gjurmëlënës edhe në pushtetin ekzekutiv për të cilin edhe sot shkondranët flasin me respekt për aftësitë e tij komunikuese e zgjidhjen e halleve të popullit si Sekretar i komitetit ekzekutiv Shkodër.

**Gjokë Pjetra** – Nënnavriq. E filloi punën në kurset e analfabetizmit, pastaj në konsolidimin e arsimit fillor sidomos në fshatin Nënnavriq derisa aty doli në pension. Nxënësit e tij gjithnjë shkëlqenin në ciklet e epërme të shkollës.

**Marash Miruku** – Palaj, Shosh. Me arsim të mesëm pedagogjik. Shquhej si mësimdhënës dhe rrezatonte shumë kulturë. Ra në krye të detyrës ku në moshë të re ja morën jetën forcat e natyrës.

**Vat Gjesh Brraka** – Lekaj, Shalë. Fillesat e punës së tij ishin në zonën e Shalës, ku ne nxënësit e tij më vonë e gjykojmë si mësimdhënës i mirë. E vazhdoi më vonë punën si mësues në Lezhë e sidomos drejtues i pushtetit ekzekutiv ku me punën e tij pati fituar respektin e të gjithëve.

**Ndue Kroni** – Theth. Shërbeu në shumë shkolla si mësues e drejtor si në Toplanë, Vuksanaj, Ndërllysë e të tjera, me devotshmëri si shumë të tjerë.

**Gjergj Kroni** – Theth. Me arsim të lartë Histori - Gjeografi. Gjeografia e shkollave ku ka shërbyer është shumë e gjerë si në Pult, Shosh, Temal, Prekal e të tjera. Ka qenë korrekt si mësimdhënës.

**Zef Delia** – Gimaj. Shumë korrekt në punë si mësimdhënës për periudhën që punoi në shkollat Gimaj e Breglumi. Ishte edhe mik i librit ku biblioteka e tij shquhej ndër të tjerë.

Përveç të mësipërmeve që patën një kohë të gjatë në arsim, pati edhe një kategori tjetër që u aktivizuan për vënieën e bazave të arsimit fillor, të cilët më vonë kaluan në sektorë të tjerë të ekonomisë apo gjetkë si dhe disa që vdiqën në moshë të re ku sapo kishin hedhë hapat e parë në arsim. Këta ishin: **Prellë Gjinesha** – Gimaj; **Zef Gjesh Fierza** – Theth; **Pëllumb Lulash Malaj** – Lekaj; **Pjetër Kola** – Abat; **Mhill Marku** – Vuksanaj; **Ndue Çuni** – Plan, i cili vdiq në krye të detyrës në Pog; **Ndoc Marashi** – Theth; **Sokol Marashi** – Lotaj; **Gjergj Kola** – Pyllaj; **Mhill Pjetër Mici** – Pyllaj; **Ndoc Mhill Zhuri** – Lotaj; **Gjin Kol Avdia** – Gimaj; **Mire Çarku** - Theth mësuese e përkthuese; **Lekë Qeftaj** - Plan (Boks); **Age Gjokë Marku** – Nënnavriq, të cilës në moshë të re forcat e natyrës ia ndërpre në mes

ëndrrën për të vazhduar kontributin në arsim, ishte mësuese në Ndrejaj (Shosh); **Mirash Binoshi** – Lotaj, që më vonë punoi në sektorin ushtarak deri në rangje të larta; **Ndue Pjetër Marku** – Nënnavriq; **Mirash Zef Preka** – Lekaj; **Shaqe Zogja** – Theth; **Mire Kokerrja** - Palaj e të tjerë. Ka pasur edhe nga ata dukagjinas, që kanë një kontribut të madh në zhvillimin e arsimit në vendin tonë me veprimtari jashtë dukagjinit si: profesor Kole Prela, Dedë Shala, Frano Gjellaj, Ndue Logu e të tjerë.

U përpoqem të përmendim mësueset që kanë kontribuar për konsolidimin e arsimit në Dukagjin. Kërkoj falje nëse kam harruar ndonjë, sepse kjo ka ardhur jo me dëshirë, por për mungesë informacioni.

Sigurisht që në shkollat e ndryshme të Dukagjinit kanë shërbyer me devotshmëri edhe mësues nga Shkodra e Rrethinat e saj, të cilët nuk jetojnë më, por që gëzojnë respektin tonë dhe meritojnë falënderime për punën e bërë.

Të gjithë këta që u cilësuan më lart qëndrojnë stoikë në kujtesën tonë dhe u jemi mirënjohës për punën e madhe që kanë bërë në vendosjen e bazave të sistemit arsimor në Dukagjin e konsolidimin e tij në të gjitha nivelet. Puna me përkushtim i tyre duhet të shërbejnë si model e shembull frymëzimi për mësueset e sotëm kudo që japin mësim e sidomos atyre të rinj në mënyrë, që ta justifikojnë besimin e dhënë e misionin fisnik të mësuesit pavarësisht nga neglizhenca e shtetit për të kontrolluar punën e tyre. Vetëm kështu arsimi kthehet në nivelin e kërkesave të kohës sepse momentalisht arsimi është bërë si lisi në derë të farkës duke futur duart gjithkush në të, duke e kthyer në eksperimental, duke bërë gjithçka vetëm jo për ti pajisur nxënësit me sa më shumë dije. Për këtë të fundit shteti nuk merret. Sot mësuesi është shumë i penalizuar dhe nuk është i lirë në punën e tij. Pa ngrit në lartësitë e kërkesave, pa i rrit autoritetin që duhet të ketë, duke rrit edhe kërkesën e llogarisë, arsimi nuk arrin në nivelin që duhet të ketë. Kushtet janë më të mira e niveli më i ulët i arsimit se sa më përpara. Të gjithë duhet të ngrihen në një front për ta eliminuar këtë paradoks. Është i madh numri i mësuesve të cilët japin mësim në shkolla të ndryshme të Qarkut të Shkodrës, të cilët duhet ta justifikojnë veten, të cilët duhet të kenë parasysh thënien e Shenjtores Terezë: *“Jo të gjithë mund të bëjnë gjëra të mëdha por, secili të bëjë gjëra të vogla me dashuri të madhe”*.

Prelë Shytani

## Profil intelektual

# Më shumë se një urim për datëlindje, 50 vjetori i Zef Gjetes

Jo shpesh në gazeta dhe në media vizive, shkruhet dhe flitet për persona apo personalitete të ditëve tona që kanë një qasje pozitive ose e përmbledhur; janë intelektuale të vërtetë evropian. Një jetë e trazuar në politikë, një ekonomi e pa stabilizuar me një varfëri të madhe, një mjedis shoqëror me kriminalitet - pra në ditët tona më shumë në medime dalin njerëz negativ, të cilët i urren, nuk të mbetet gjë në kujtesë për të mirë. Duhet konsideruar si fatkeqësi e kohës dhe shoqërisë, sa fëmijët tanë, brezi që po rritet nuk arrin të njoh sa duhet, modelin e qytetarit dhe intelektualit të vërtetë të pagatitur për në familjen evropiane. Kjo periudhë demokracie (më mirë duhet thënë pluralizmi pa rregulla) ka nxjerr njerëz te suksesshëm në fushën dhe profesionin e tyre, si veprimtar shoqëror, model në sjellje dhe komunikim, e të tjera. Këta shembuj model të njerëzve të suksesshëm, me të cilët në jetojmë i kemi afër, e njohim punën dhe kontributin e tyre, jo gjithmonë i bëjmë të njohur sa duhet. Kjo, jo për ti thënë fjalë të mira dhe elozhe për të krijuar opinion, por, kjo duhet vlerësuar si një drejtim edukimi që brezi më i ri, të njohë këta individë model për të qene si një shembull që duhet ndjekur. Një shoqëri si e jona, në fakt ka nevojë për shembuj të mirë, nëpërmes tyre ndoshta do të mund të orientohemi për një prosperitet dhe një të ardhme të mirë.

Nuk dua të them se ndoshta dhe ndonjë xheloz primitiv behet pengese për të tilla shkrime. Ashtu si nuk na mungon guximi shpesh duke kaluar dhe ndonjë sens etik (pas krahëve) të themi ndonjë të keqe për punën, për ndonjë kolegë, më shumë duhet të jemi të prire për të bere si thonë vlerësimin e kontributit të secilit aq më shumë të ndonjërit që spikat me punën dhe marrëdhëniet me koleget në terezinë e shoqërisë tone.

Është shkruar diku: "Shembulli nuk është gjëja kryesore që ndikon në tjerët, por ndoshta është gjëja e vetme! Të faleminderit për dhënien e tij!!" Një shembull i mirë midis kolegeve, miqve dhe të njohurve veçohet Prof. As. Dr. Zef Gjeta. Është ky specialist bujqësie dhe zhvillimi rural që ka kontribute të tij dhe njihet nga Tropoja në Sarandë, me shumë miq dhe bashkëpunëtorë të fushave të ndryshme. Veprimtaria, për rreth çerek shekulli zë fill si specialist i kërkimit shkencor në Institutin e Misrit dhe Orizit në Shkodër, për të vazhduar si specialist dhe drejtues projektesh në mjaft organizata vendore dhe ndërkombëtare Evropiane dhe të OKB-

se, në Tirane.

Jo të gjithë njerëzit që Zefi i takon apo i kane dëgjuar emrin ja njohin vlerat e punës dhe kontributin në fushën e tij, si agronom, krijues dhe botues, por kushdo që ka takuar qofte dhe njëherë është miqësuar dhe afruar me të si i njohur i vjetër. Është kjo cilësi e karakter njerëzore i jashtëzakonshëm, ky komunikim i ngrohet në mjediset që ai krijon, që njerëzve ju mbetet në kujtesë, me shenjet dhe këshillat që ju jep. Edhe pse flet me një "gjuhe shkodrane" ai gjënë mënyrë dhe behet i kuptueshëm e i pëlqyeshëm kudo në mjediset intelektuale dhe midis fermerëve dhe nxënësve.

Veprimtaria e Zefit është në këtë periudhë tranzicioni - duhet konsideruar e vështirë, por dhe e arrirë. Në vitin 1990 ai ishte një agronom i sapo diplomuar, tashme pas 25 vitesh, në saje të



një pune të paepur, me një përkushtim real model, të materializuar në studime, raporte, monografi dhe kërkime të mirëfillta shkencore është në pragun e marrjes të titullit "Profesor". Me mijëra intelektuale në këto kushte dhe mjedis shoqërorë kanë zgjedhur emigrimin për një jetë më të mirë. Edhe Zefit i janë krijuar mundësitë ndoshta është ndër specialistet e pare që pati mundësi punësimi dhe shkollimi jashtë vendit, por duket se këto nuk e joshen - ai donte të sfidonte, të përballlej me ato që po sillte ky ndryshim në Shqipëri, të mund të kontribuonte në politike apo dhe si specialist i fushës. Zefi pëlqeu më mirë këtë "Ferrin e Tij" se "Parajsën e Huaj".

Zef Gjeta, ka njohje dhe bashkëpunime ndërkombëtare, ka marre pjese në shume konferenca, ka njohur e marre përvojë në shume vende të zhvilluar në bujqësi e zhvillim rural, si anëtar në disa forume dhe organizata brenda dhe jashtë vendit, e gjithë kjo veprimtari është drejtuar nga ai që të mund të bej ndryshime e përmirësime kryesisht në jetën rurale në vendin tone. Janë dhjetëra projekte që ai ka ideuar e realizuar me sukses

në kuadër të zhvillimit të jetës në fshat, ndërkohe si konsulent i përzgjedhur nga organizatat ndërkombëtare me emër në Bote, ka përgatitur raporte të nivelit të larte informimi dhe saktësie të vlerësuar prej tyre.

Nuk dua të jem në "konflikt interesi" me gazetën dhe shoqatën atdhetare "Dukagjini", me këtë shkrim ku Zefi veçohet si njeri nder anëtarët me aktiv të sajë. Ai, në Degën e Tiranës, por dhe në Shkodër është i përfshirë në shumë veprimtari duke pakësuar kohën në shërbim të familjes dhe interesave të ngushta private.

\*\*\*

Për Zefin, mund të shkruhej gjate dhe nga shumë miq dhe bashkëpunëtorë të tij. Me shume gjera mund të njihen, nëse mund ti referohemi CV-se pasur të

në disa projekte të BE, Lektor, titullar i lëndës "Menaxhimi i Ciklit të Projekteve". Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit, Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Fakultetit të Mjekësisë, në degën Shëndeti publik,

2010 -2013, FAO Koordinator Kombëtar i Programit UNICEF dhe OBSH

2009 -2010, UNDP - Koordinator Kombëtar i Projektit të Blegtorisë

2009, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë Ekspert i Projekteve dhe Trajnimeve

2007 -2009, MADA, Drejtor Departamenti Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore në

2003 -2006, FAO / GCP / ALB / 005 Oficer Kombëtar, Projekti për Mbështetjen e Prodhimit Bujqësor

2002 -2003, Oficer Kombëtar Projekti i Shërbimeve Bujqësore ASP, i Bankës Botërore

2001 -2002, Ekspert Kombëtar, MADA Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore

1999 -2001, oficer në VSO (Organizata e Vullnetarëve të Përtejdetit)

1998 -2001, Oficer Kombëtar Projekti FAO Alb/96/008

1996- 1998, Kërkues shkencor, Instituti i Misrit dhe Orizi, Shkodër

1993 - 1996, Drejtor i departamentit të botimeve Shoqata "Hokartari"

1990 -1993, Kërkues shkencor Instituti i Misrit dhe Orizi, Shkodër,

Është me profesion agronom, grada shkencore; profesor i asociuar dhe doktor i shkencave bujqësore.

Është nismëtar i gazetës - revistës "Humor Shkodran".

Ai, në vitin 1998, pas rënies së sistemit komunist, organizoj së pari festën e Karnavaleve të Shkodrës së bashku me grupe artistike dhe intelektuale të qytetit. Kjo feste tashme kremtohet çdo vite me pjesëmarrje dhe nga jashtë Shkodrës.

Komunikon në: **Anglisht, Rusisht, Italisht dhe Greqisht**

**Botime shkencore dhe letrare**

Autor i shume artikujve shkencorë e divulgues, udhëheqës në 15 punimeve të ndryshme shkencore, hartues dhe zbatuesi i rreth 40 projekteve bujqësore në komunitet.

Autor i 10 librave humoristik për të rritur dhe fëmijë

Autor i 14 librave në fushat e bujqësisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm rural, monografi, e të tjera

Autor i librit universitar "Cikli i Projektit" dhe njohës e praktikues i 3 gjuhëve të huaja.

Gjon Fierza

# Pse bëjmë gabim, kur nuk kujtojmë Gjergj Kastriotin?!

Besi BEKTESHI

Vendet e vogla, e kanë vështirë të krijojnë jo vetëm legjenda të mëdha, por as mite të mëdha, dhe për më tepër heronj të mëdhenj! E kanë të vështirë për hapësirën territoriale dhe popullsinë. Por populli shqiptar, territori shqiptar, me një fjalë kombi shqiptar, e kanë një figurë të stërmadhe që ka brenda legjendën, mitin dhe heroin e madh - që i bën nder pikërisht kombit në sy të të gjithë kombeve të tjerë jo vetëm europianë dhe ballkanikë, por akoma më shumë në botë. Sigurisht që ky është Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe me të, nuk ka të krahasuar asnjë figurë tjetër shqiptare që sigurisht renditen për nga lavdia dhe fama mbas tij si njeriu që për një kohë të caktuar mblodhi shumicën e shqiptarëve dhe luftuan me fuqinë më të madhe të kohës! Para dy ditësh kishte përvjetorin e vdekjes. U kujtua sigurisht, por më shumë nga një pjesë njerëzish në FB. Sigurisht kjo gjë është e mirë, por pse sërish na duhet si figurë e madhe kombëtare? Si parantezë jam i detyruar të tregoj një moment të trishtë që demonstron lëkundjen etike dhe morale të kohës në marrëzinë e dyshimtë të saj sot. Brenda një dite, një person thotë se nuk e respekton Gjergj Kastriotin se e ka lavdëruar komunizmi dhe Enver Hoxha! I dyti nuk e donte se kishte vlarë muslimanë dhe i treti nuk e respekton se si turk dhe musliman kishte vlarë të krishterë! Më marrëzi dhe më varfëri psikologjike dhe historike se sa kjo, nuk ka shanse ti ndodhë një shoqërie që po prish drejtpeshimin e saj historik dhe kombëtar! Dikush këtë marrëzi dhe plaçkitje historike, këtë vagabondazh historik dhe këtë devijim moral kombëtar e paraqet si hap përpara në histori! Nëqoftëse Enver Hoxha dhe diktatura, e paska ngritur në pedestal një hero kombëtar dhe të dekoruar prej saj - jo vetëm që ka bërë mirë, por është një nga veprat e saj, të akademisë së saj, të historiografisë së saj më të mirë, dhe as që më plas fare se e ka bërë diktatura dhe ai sipër saj si një nga kriminelët më të mëdhenj të popullit të tij që quhet Enver Hoxha! A thua se diktatorët e tjerë - nuk paskan nderuar heronjtë e tyre kombëtar?! Nejse, kështu medemek antikomunistësh idiotë mbase mund të ketë sërish - por janë specie në zhdukje për fat të mirë pak se ashtu ishin dhe shumë se ishin ish komunistë të "konvertuar në demokratë". Kurse ata që nuk e duan se ka vlarë muslimanë dhe ata që nuk e duan se paska vlarë katolikë (më pak këta të fundit) janë produktet e fundit - të dyerve të shqyera ideologjike dhe religjionare që vijnë me mësim nga shkollat e rrapullisë religjionare në botë, të lejuara te ne, në mënyrë absurde! Ne sot bëjmë gabim që nuk e kujtojmë Kastriotin për shumë arsye dhe e para është ajo që ne krenarinë

e shtetit të parë dhe drejtuar pa qenë i shpallur Mbret nga Kastrioti, i cili përballi fuqinë më të madhe të kohës" nuk duhet dhe shtojmë në faj dhe ta harrojmë. Ajo duhet të jetë periudha e lavdisë tonë kombëtare dhe nuk ka të dytë që të krahasohet me të, për nga veprat e mëdha jo thjesht luftarake, por shtet formuese dhe shtet mbajtëse në botë. Vetë Europa e sotme, që vendos kushte të na pranojë - kishte atëhere një kusht të madh të



mbijetesës së saj, në formën që është sot përballë një fuqie të shkëlqyer ushtarake dhe perandori të madhe si ajo Osmane, dhe kjo ishte pikërisht si "shtet - lidhje" që drejtohej nga Kastrioti. Pastaj - Kastrioti, është e vërtetë se u kthye në religjionin islam kur u dorëzua i vogël dhe pastaj te garda e Jeniçerët dhe shumë shpejt për betejat dhe trimëritë e tij në shërbim të portës arriti dhe gradën e Sanxhakbej - ai ishte dhe musliman dhe pothuaj një bektashi si pothuaj të gjithë jeniçerët, por ishte dhe i edukuar me artin më të lartë të luftës dhe njohës i shumë gjuhëve të botës, diplomacisë, dhe drejtimit politik. Asnjë në famë dhe luftë nuk ka shkuar përpara si ai dhe pse nën drejtimin e sidomos Sulltan Muradit. Ai përfaqësoi dhe në perandorinë e madhe Osmane, njeriu e përgatitur akoma më me famë luftarake se sa pothuaj moshatari i tij ose Sulltan Mehmedi, me të cilin do të luftonte më vonë. Ishte marrë peng sikundër ishte zakoni si pasojë e humbjes së luftës së babait të tij Gjon, por arriti të bëhej ylli i perandorisë në arte luftarake dhe në moshë të vogël - gjenerali më me famë si për kurajon dhe trupin e tij të stërmadh për kohën. Sigurisht për Sulltanin dhe Osmanët, ka bërë lufta të mëdha dhe të fituara, por kjo nuk mund të jetë arsye për urrejtje dhe pathos idiot religjionar. Padyshim që u

rikonvertua dhe njëherë në kristianizëm dhe ky është dhe qëllimi final i bashkimit jo vetëm të tokave të babait por dhe të prijësve shqiptarë të shpërndarë dhe në luftë me njëri tjetrin. Gjatë jetës së tij Kastrioti ka bërë 30 beteja dhe prej tyre ka fituar 29 dhe të gjitha ishin të forta dhe një gjakderdhje e madhe luftarake me strategji të fituar dhe jo vetëm trimërisht apo burrërisht sikundër dikush mundohet të thotë?! Nuk vlen sërish të thuhet ash ka vlarë muslimanë, sepse po luftonte jo vetëm dhe thjesht për krishterimin, por padyshim shumë më shumë, për vendin dhe flamurin shqiptar apo atë që ngrihej mbi të tjerët - Kastriotit?! Mbajti larg për 25 vite fuqinë dhe makinerinë më të shkëlqyer luftarake si ajo e Otomanëve? Pa ndonjë ndihmë kaq të madhe pa ndonjë përkrahje të vërtetë nga Europa e krishterë, nga Papati, nga Mbretët të shumtë që sigurisht edhe shpresonin te Kastrioti dhe dishonin te vendi i vogël që ai po mbronte nga fuqia më e madhe e kohës, që i bënte të dridheshin shumë prej tyre. Ai u bë "kapiteni i parë" i mbrojtjes së kufirit mes Perandorisë së madhe Osmane dhe Perëndimit të Krishterë?! Ishte i vetmi kalorës i madh që përballë me Osmanët i vetëm me princat shqiptarë dhe fitonte po ashtu i vetëm, por duke bashkuar shqiptarët. Sigurisht që Lidhja Shqiptarëve është një vepër e madhe e tij dhe princave shqiptarë dhe kjo lidhje ishte, është, dhe do të jetë burim frymëzimi i tyre. Ishte për Lidhjen e Prizrenit, Rilindjen Kombëtare, Pavarësinë e Shqipërisë, Mbretërinë Shqiptare, Luftën Nacional Çlirimtare, regjimin komunist dhe duhet të jetë dhe në demokraci?! Historia ka fajet dhe të mirat e saj, por ky moment dhe lufta e Kastriotit, mbeten frymëzimi dhe shembulli më i madh kombëtar në fitore mbi armikun dhe shtetërim me shqiptarë të bashkuar. Figura e tij në buste dhe shtatore, në piktura është më e përhapura në botë. Është tipikisht shqiptare dhe me vepra në Shqipëri, por dhe kryevepër e Europës jo thjesht të krishterë se sa të shembullit se si një vend i vogël përballë me superfuqinë e kohës dhe del fituese për një çerek shekulli. Një deklaratë akoma jo mirë e verifikuar tregon se ai e ka quajtur veten "Pirron e ri të Epirit" dhe për këtë papa Piu II donte dy herë të vinte në Shqipëri me objektivin për ta shpallur Mbret të saj dhe në disa dokumente vërtetohet kjo gjë. Do të kishte qenë një mrekulli, por sigurisht për shumë arsye nuk u bë kjo gjë, duke penguar një pjesë të mirë të historisë të kishte dhe Mbretin e Epirit dhe trashëgimtarët e tij. Pra një mbretëri të vërtetë në anën tjetër të Adriatikut me Italinë dhe papatin?! Në kohën e tij u bënë të famshëm dhe shumë familje

princash shqiptarë me emër të shquar prej kohësh, por me lavdi të fituar në këtë kohë. Bashkimin kombëtar ai e shikonte dhe me martesat mes princave veri e jugë si vetë martesa e tij me vajzën e Aranitëve. Nuk ka bibliotekë kombëtare të rëndësishme, por dhe ndërkombëtare që nuk ka modele dhe shembuj të veprës së tij dhe për të ka opera e vepra muzikore e teatrale në botë. Portreti i tij i parë mund të jetë ai i vitit 1466 i Gentile Bellini kur Kastrioti ishte në Itali dhe autori i dytë është Friedrich Kenner. Kryesorja pse bëjmë gabim kur nuk e kujtojmë është se "ne nuk kemi luksin si popull dhe komb i vogël, të mos kemi figurën tonë kombëtare me famë ndërkombëtare si fokus hoistorik dhe krenaria kombëtare"?! Kjo figurë është bërë dhe model i vjedhjes historike te serbët, maqedonasit dhe të tjerë popuj - por tashmë bota e di mirë se është shqiptar dhe lartësi të tillë në Ballkan dhe Europë. Pikërisht kjo figurë që na shërben për bashkimin tonë dhe përballë europianëve për t'ju thënë se "ishin dhe jemi ai komb Ne sot bëjmë gabim që nuk e kujtojmë Kastriotin për shumë arsye dhe e para është ajo që ne krenarinë e shtetit të parë dhe drejtuar pa qenë i shpallur Mbret nga Kastrioti, i cili përballi fuqinë më të madhe të kohës" nuk duhet dhe shtojmë në faj dhe ta harrojmë. Ajo duhet të jetë periudha e lavdisë tonë kombëtare dhe nuk ka të dytë që të krahasohet me të, për nga veprat e mëdha jo thjesht luftarake, por shtet formuese dhe shtet mbajtëse në botë. Vetë Europa e sotme, që vendos kushte të na pranojë - kishte atëhere një kusht të madh të mbijetesës së saj, në formën që është sot përballë një fuqie të shkëlqyer ushtarake dhe perandori të madhe si ajo Osmane, dhe kjo ishte pikërisht si "shtet - lidhje" që drejtohej nga Kastrioti... që luftuam i vetëm në mbrojtje dhe tuajën" dhe përballë Turqisë mike të sotme, për ti thënë se sigurisht kemi histori të përbashkët të një figure e cila është kaq e madhe dhe luftarake sa duhet respektuar si gjithë figurat e tilla të mëdha në botë për nga rëndësia e tyre, veprat dhe lidhjet që koha krijon për ti përballur më vonë?! Dakord? Ne nuk mund ta bëjmë gjakun ujë dhe nuk mund të ulin dhe çmitizojmë figura që kalojnë përmasat dhe të miteve, me veprat e bërë në kohë të tyre. Nuk mund t'ju shkojmë pas njerëzve sharlatanë që nuk duan krenari kombëtare se kanë inat dhe me veten, as të çmendurve religjionarë dhe as injorantëve që nuk kanë lexuar dhe kuptuar dy rreshta. Kjo figurë është e madhe dhe ato që nuk kujtohen sigurisht janë të vegjël. Kjo është koha e të vegjëlve, por që nuk do të shkojë shumë dhe do kthejë kohën e figurave të mëdha të kombit, ku më e ndritura dhe e madhja është ajo e Gjergj Kastrioti Skënderbeut.

# Lazër Stani: Dritëroi, poet i tokës dhe i shpirtit shqiptar



**Fillimisht do të donim të dinim, si e keni njohur Dritëroi Agollin?**

Fillimisht e kam njohur nga poezitë, si lexues që kur isha nxënës shkolle, siç e kanë njohur shumica e shqiptarëve. Mbjaj mend, pas shkollës së mesme, kur po bëja stazhin, u botua një libër me poezi të zgjedhura të Dritëroit, me kopertina blu. Atë libër e kam mbajtur shumë kohë në dorë dhe disa vargje lirike të botuara në atë libër i mbaj mend edhe sot e kësaj dite, si vargjet e poezisë "Mollët", për shembull.

*"Ajo binte erë mollë atë natë / Atë natë rinore pa trazira / Nuk më kujtohet se ç'i thashë / Por di që i thashë fjalë të mira"*

Por në atë kohë as mund të ëndërroja se një ditë do ta takoja poetin e madh, që ishte edhe i pari i shkrimtarëve shqiptarë në krye të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve. Por fati e solli që disa vite më vonë, kur isha student në Fakultetin e Shkencave të Merrja pjesë në një takim të shkrimtarit, me studentë të zhvilluar në një sallë në Pallatin e Kulturës "Ali Kelmendi", aty ku është sot Albanian University. Dritëroi po fliste për poezinë, i gjallë, i mençur me një elokuencë që të bënte për vete. Tha diçka për poezinë hermetike, që sipas tij i ngjan monologut të morgut në manastir, që i thotë lutjet e tij në vetmi, i pa kuptuar e i padëgjuar nga askush. Shtoi se poezia duhet të komunikojë, të emocionojë dhe të zgjojë shpirtat njerëzorë. Foli pastaj për modernizmin dhe tha se modernistët, përpiqen ta kruajnë veshin e majtë me dorën e djathtë dhe anasjelltas, duke u stërmunduar e zgjatur krahun pas qafës. Dhe bëri gjestin përkatës që ne na shkaktoi të qeshura. Tregoi edhe për një ngjarje që lidhej me një tregim, të censuruar nga redaktori skematik. "Nëse do ta botosh tregimin, i kish venë kusht redaktori, kësaj femrës duhet t'ia presësh

sisët. Kështu që nëse ndonjëri nga ju e ka lexuar atë tregim, ka gjetur një femër pa gjoks, cica prerë, të operuar në mënyrë të shëmtuar. Po femrat kanë sisë të bukura apo jo?" Ne po e dëgjnim gojëhapur, të emocionuar dhe fakti që e mbaj mend këtë bisedë të vitit 1983 edhe sot e kësaj dite, e dëshmon këtë. Por prapë si student i shkencave, as që e mendoja se do të takoheshim ndonjëherë dhe për më tepër do të ishim miq. Por kjo ndodhi, dikund në fund të viteve tetëdhjetë, kur unë kisha botuar dy - tre tregimet e para në shtyp. Dritëroi dha një intervistë në gazetën "Drita" dhe mes dy - tre emrave të shkrimtarëve të rinj që përmendte, i pari ishte emri im. Kjo nuk ishte gjë e vogël, ishte shumë e madhe për mua, se unë ende nuk kisha botuar një libër. Pas ca ditësh u takuam në shkallët e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe i zgjata dorën dhe iu prezantova. Ai më hodhi dorën në qafë, më përqafoi dhe më ftoi për kafe. Biseduam aq lirshëm për më shumë se dy orë, sa ngjanim si dy miq të vjetër që i kanë munguar gjatë njëri - tjetrit dhe

mend të më ketë folur për parti dhe partishmëri dhe budallallëqe të tjera të kësaj natyre. Ishte vërtetë një burrë i zgjuar që dinte si të fliste e të bënte për vete atë që kishte përballë. Dhe me mua, besoj se ndihej krejt i lirë, i ç' prangoste fjalët, mendimet.

**A e përkrahte Dritëroi një shkrimtar të talentuar nëse e spikaste?**

Janë të shumtë shkrimtarët që i ka përkrahur në fillimet e veta letrare, e thonë këtë apo jo. Unë po tregoj një rast shumë domethënës. Në maj të vitit 1989 u njoha me poetin Luljeta Lleshanaku. I botova një cikël me poezi në gazetën "Zëri i Rinisë", poezi që ajo nuk mi kishte sjellë mua, po redaktorit përkatës në redaksi, para dy muajsh. Pas një telefonate të rastësishme që pata me Luljetën, ndërmjetësova t'i botoheshin poezitë te kryeredaktori. Një ditë më pas vjen Remzi Lani në zyrë dhe më thotë se bëmë gabim që i botuam poezitë; ajo është me biografi të keqe, por nëse të pyesin ty thuaj nuk kam ditur gjë. Ashtu do të them edhe unë. E kuptova se Luljeta nuk do

Abaz Kupit".

Bardhi u mvrejt në fytyrë dhe heshti një grimë.

Po për Alush Lleshanakun ke dëgjuar? - e pyeta.

Bardhi ngriti kokën dhe po më shihte i çuditur. Sikur më thoshte: "Ç' dreqin tjetër ke për të thënë.

"Kë dëgjuar për Alush Lleshanakun?"

"Si nuk kam dëgjuar", tha.

Është mbesa e tij, vajza e vëllait të Alush Lleshanakut, dhe shtova: Bijë armiqsh më damkë, jo dosido".

Bardhi, të cilin e kisha mik prej vitesh, po më shihte çmeritur, sikur thoshte ç' dreqin të ka hipur në kokë sot. Pas një pauze, Bardhi tha, ngjitemi e ia japim Dritëroit t'i lexojë. Nëse ai i merr përsipër unë do t'ia botoj. U ngjitëm të dy bashkë në zyrën e tij, ia dhamë poezitë t'i lexonte, pasi i treguam për lidhjet e autores me Abaz Kupin dhe Alush Lleshanakun.

Dritëroi, pasi i lexoi tha se jo vetëm do të botoheshin, por do të shkruante edhe një prezantim për poezinë e poetes. Përgjegjësinë për botimin e merrte

ai. Atu ndërhyri Bardhi, më dashmirësi, që ta mbronte: "Prezantim mos bëj, i tha, i botojmë vetëm poezitë. Prezantimi me fjalët tua do të ishte provokim i madh". Ashtu ramë dakord dhe unë me Dritëroin zbritëm në kafe, ndërsa Bardhi shkoi në zyrë me poezitë në dorë.


"Si kështu more Dritëroi, ti ke bërë dhe poezi kundër Abaz Kupi t...", i thashë unë duke qeshur.

"E ç' kam thënë në atë poezi?", - më pyeti.

"Kë thënë se brydhte me kalë me faqoren e rakisë në xhep".

"Hahaha, qeshi. Po gjëra burrash i paskam thënë nuk e paskam sharë. Dhe si u mendua një grimë shtoi: Ka qenë trim, trim i çartur. Dhe patriot."

Atë shtator i kërkova Dritëroit një rekoman-



që kanë shumë gjera për t'i thënë sho-shojt. I ngrohtë në bisedë, i afërt, i sinqertë dhe me humor, të bënte të ndihesh i barabartë, si më ndonjë nga shokët e tu të shkollës. Nuk e di se si, por që në takimin e parë, i drejtohesha me Dritëroi dhe ti, dhe them se ishte aftësia e tij e veçantë që ma krijoi këtë afërsi dhe këtë ngrohtësi, thujse prej prindi të dashur. Pas atij takimi të parë në takoheshim shpesh, pinim kafe, bënim humor, qeshnim me zemër, flisnim për letërsinë dhe librat. Në këto takime, kurrë nuk mbaj

të mund të botonte më poezi në "Zërin e Rinisë" dhe disa muaj më vonë, nga mesi i verës, Luljeta më sjell një cikël poezish, të cilat ia shtypa në makinë shkrimi dhe ia dhashë Bardhyl Londos për t'i lexuar. Bardhi i pëlqeu menjëherë dhe tha se do t'i botonte. Qesha. Kurrësi nuk mund ta rrezikojë mikun tim, por u kënaqa që edhe ai si poet i pëlqeu poezitë e Luljetës.

"Bardhi, i thashë, a ke dëgjuar për Abaz Kupin?"

"Si nuk kam dëgjuar, tha, pse?"

"Se nëna e Luljetës është mbesa e

dim për Luljetën, që të vazhdonte shkollën, ngaqë për shkak të biografisë, ajo nuk mund t'i vazhdonte studimet e larta. Ma dha rekomandimin menjëherë me fjalët më vlerësuese, por shefi i arsimit të Krujës e gjuajti menjëherë në koshin e plehrave, duke sharë diçka nëpër dhembë. Fjala e tij, mbështetja e tij, rekomandimi i tij, pavarësisht pozicioneve politikë që kishte, nuk pinte ujë as të një shef seksioni arsimit, le më kund tjetër. E tillë ishte Shqipëria në atë kohë, i tillë ishte regjimi, i tillë ishte edhe autoriteti real i shkrim-

tarit në pushtetin e zi të diktaturës.

#### **Juve vetë, kur dhe si është përpjekur t'ju përkrahë?**

Në ditët më të zeza më është gjendur në krah, si një mik, si një prind, pavarësisht se çfarë mund të bënte në të vërtetë. Thashë se, si shkrimtar më përkrahu që në tregimet e parë, por përkrahjen më të madhe ma dha pas shtatorit të vitit 1990, kur më pushuan nga puna në gazetë, më shpallën armik me urdhër nga lart, ca zyrtarë rinie, që sot bëjnë profesorin dhe patriotin, më degdisën në Klllojkë, duke përgatitur kështu arrestimin tim. Unë refuzova të shkoj në Klllojkë dhe u ktheva në shtëpinë time, në Dukagjin, i papunë, sepse nuk pranoni të më dërgonin as si mësues. Atje ku donin ata ose hiç. Dhe unë nuk pranova t'u bindesha se e njihja mirë atë regjim, e dija rrezikun. Në tetor, pra pas disa javësh, në konferencën për letërsinë që mbahej në Korçë, ngrihet Todor Keko dhe thotë se gjithë ato që thonin për liberalizimin dhe për demokratizimin janë broçkulla se ju para tre javësh hoqët nga puna dhe internuat një shkrimtar të talentuar, Lazër Stanin. Në sallë shpërtheu protesta dhe Dritëro Agolli, që ishte në panel, tha atë që nuk pritej:

“Lazër Stanin do ta marr unë në punë”.

Me sa duket, sigurimi i shtetit, që i përgjonte shkrimtarët hap pas hapi, që të zhvleftësonte këtë protestë të tyre dhe që Dritëroi të mos bënte ndonjë budallallëk e të më merrte në punë në Lidhjen e Shkrimtarëve, hapi të nesërmen fjalën se Lazër Stani është vrasë në kufi së bashku me të shoqen në tentativë arratisjeje. Me qanë të gjithë, miqtë, shokët, kolegët, madje edhe të afërmit e Luljetës, sepse lajmi kishte marrë dhenë, po unë nuk dija gjë i ngujuar në shtëpinë time. Pas ndonjë javë, miku im Faruk Myrtaj guxoi me ndihmën e një kolegu gazetar në Zërin e Popullit, të merrte në telefon centralin e Pultit, zona ku banoja unë dhe më çon fjalë të vija urgjent në Tiranë. Kur zbrita në stacionin e trenit në kryeqytet, miqtë që kishin dalë të më prisnin, nuk u besonin syve.

Lajmi i vdekjes ishte i sigurte se kishte dalë nga burime të Ministrisë së Brendshme. Bardhyl Londo, më shihte përbalë tij në tavolinë, në kafën e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe i rridhnin lot. Atë janar fillova punë në Lidhjen e Shkrimtarëve, në gazetën “Drita” me vendim të Dritëroit. Por Komiteti ekzekutiv i Tiranës, që posedonte dosjen time të kuadrit, nuk pranononte t'ia jepte atë Lidhjes, me pretekstin se unë kisha thyer urdhrin, nuk isha paraqitur në punë ku më kishin emëruar, edhe pse tashmë ishte shpallur pluralizmi politik.

“Ta mbajnë, ta ziejnë e t'ia pinë lëngun, tha Dritëroi i zemëruar. Ti vazhdo punën e mos vrit mendjen”. I tillë ishte Dritëroi Agolli.

#### **Sipas këndvështrimit tuaj, si është vepra letrare e Dritëroit?**

Dritëro Agolli ka një krijimtari të gjerë: është së pari poet, po edhe tregimtar nga më të mirët, (të kujtojmë “Era e zhurmave të dikurshme”) romancier, dramaturg, mendimtar. Krijimtaria e tij është e lidhur ngushtë me njeriun shqiptar, me shpirtin e tij, me tokën dhe historinë, me dramën tonë ekzistenciale. Është lirik i

ngrohtë dhe i butë, si era pranverore që fryn mbi qilimin e luleve në livadh, është i ndjeshëm deri në këputje kur i këndon dashurisë, është i thellë dhe dramatik kur i këndon jetës, plakjes dhe vdekjes dhe natyrisht, është patetik kur i këndon revolucionit. Zyloja mbetet një ndër romanet më të mirë, një parodi e hidhur për administratën e regjimit, e shkruar me humor që të bën të mbash barkun me dorë dhe që dashje ose pa dashje nëpërmjet asaj vepre tregohet se si i shfityrojnë njerëzit pushtetet absolutiste, pushtetet e dhunshme, diktaturat. Por edhe në romanet e tjerë Dritëroi di të krijojë karaktere tërësisht shqiptare, me të mirat dhe marrëzitë e tyre, që lexohen me ëndje. As që vihet në dyshim se vepra e tij e zgjedhur është një pasuri e paçmueshme e kulturës tonë kombëtare.

#### **A mundet që të na tregoni ndonjë ngjarje, në të cilën keni qenë prezentë ju me Dritëroin, që të na rrëfejë diçka më shumë rreth Dritëroit njeri?**

Unë vetëm si njeri dhe shkrimtar e kam njohur Dritëroin, kurrë si kryetar Lidhjeje, se nuk e shfaqti kurrë me mua një autoritet të tillë, jo e jo si funksionar partie, apo si deputet. Dhe larg qoftë si anëtar i Komitetit Qendror! Jo si këta të sotmit që të shikojnë nga lart, si për të vënë në dukje pozitën e tyre politike, pasi në të vërtetë nuk kanë vlerë tjetër. Mbjaj mend se u gëzua shumë kur mori vesh se Luljeta po përgatiste librin e saj të parë me poezi, u gëzua si për fëmijën e tij. Më tha që t'ia sillja librin kur ta mbaronte Luljeta, se do t'i shkruante një parathënie. Dhe ashtu u bë.

Një herë tjetër, më vjen Pano Taçi, poet që e kishte kaluar pjesën më të madhe të jetës burgjeve me një shkrim të shtypur në flet letrë e më thotë: “Lexoje çfarë ka shkruar Dritëro Agolli për mua, por nuk di ku ta botoj”. E marr shkrimin, e lexoj dhe i them Panos: “Do ta botoj nesër në RD”, gazetë në të cilën isha kryeredaktor në atë kohë. Në “RD” Dritëro Agollin? Çuditë Panua. “Po, i them në RD, madje do t'ia jap dhe një honorar të mirë”.

Të nesërmen shkrimi i botua dhe pas këtij botimi, sa herë Dritëroi fliste në gazeta kundër qeverisjes së PD-së dhe presidentit të atëherëshëm, mua më thoshin “E lexove çka shkruar Dritëroi yt?”. Ata mendonin se më akuzonin ndërsa unë ndjehesha i përkëdhelur. Dritëroi ishte tepër i madh për të qenë i një individi, i një grupi individësh, i një partie: Dritëroi ishte i të gjithë shqiptarëve.

**Ka shumë diskutime për implikimin edhe të shkrimtarëve në krimet e komunizmit. A mendoni se përgjigja më e mirë, ndoshta do të ishte hapja e dosjeve? Dhe sipas jush, për Dritëroin, sa janë gjasat që të zbulojmë një surprizë të keqe?**

Në këto njëzet e pesë vjet, për fat të keq, ka një shtrembërim të diskursit të debatit për komunizmin, diktaturën, krimet e saj. Nëse lexon çfarë shkruhet e dëgjon çfarë thuhet, duket sikur kriminelët më të mëdhenj në diktaturë na paskan qenë shkrimtarët dhe artistët. Por kjo nuk është e vërtetë dhe një shtrembërim i tillë iu vjen për shtat kriminelëve të vërtetë, atyre që vërtetë kryen krime kundër shqiptarëve. Dhe në këtë lojë të pistë, një farë roli e kanë luajtur

edhe vetë shkrimtarët në këto vite të nxitur nga xhelozitë, smira, armiqësitë që ekzistojnë midis krijuesve. Diktatura ishte një fatkeqësi për shqiptarët, komunizmi një fatkeqësi për njerëzimin. Por diktatura nuk është vepër e shkrimtarëve po e diktatorit dhe e shpurës së tij të afërt, funksionarëve partiak dhe levave; sigurimit të shtetit, gjykatave e të tjerë. Për shkrimtarët gjithashtu diktatura, ka qenë një fatkeqësi e rëndë, sepse krijuesi pa liri është si një shqiponjë e mbyllur në kafaz. Por në fatkeqësinë që i kishte rënë mbi kokë Shqipërisë edhe shkrimtarëve u është dashur të mbijetonin, të bëjnë kompromise për të jetuar e shkruar, krijuar familje e rritur fëmijë. Dhe shkrimtarët gjithmonë kanë qenë për diktatorin një kontingjent i dyshimtë, një kontingjent armiqësor potencial. Ndaj përgjoheshin, spiunoheshin, komprometoheshin, rekrutoheshin disa prej tyre, të tjerë burgoseshin, dënoheshin e në raste ekstreme edhe vriteshin siç ndodhi me dy poetët e Librazhdit, Vilson Blloshin e Genc Lekën, apo me poetin rebel Havzi Nela. Edhe nëse disa prej shkrimtarëve dalin spiunë, ky nuk do të jetë ndonjë trishtim i madh për mua, por një klithmë në ndërgjegje, që kurrë më në këtë vend të mos vijë regjime shtypëse që shfrytëzojnë dobësitë e njeriut, ambiciet, zilitë, smiratë, veset, për ta kompromentuar njeriun, për ta inkriminuar atë, shkrimtar ky ose jo. Hapja e dosjeve sigurisht është një gjë e mirë dhe unë e kam kërkuar këtë para shumë vitesh, jo për të poshtëruar e akuzuar njerëz, se unë nuk jam gjykatësi, por për të zbuluar gjithë të vërtetën e tmerrshme të atij regjimi kriminal, për të zbuluar dhe kuptuar dramën llahtarshme që ka ndodhur me njerëzit dhe fatet njerëzore.

Sa për Dritëroin, siç e kam njohur unë, nuk ka qenë njëri i prapaskenave, i punëve të zeza të natës, varrmihës i fateve të shokëve, miqve, kolegëve, shkrimtarëve dhe artistëve, pavarësisht bindjeve të tij, besimit të tij te komunizmi. Ai ka qenë njeri i hapur, i drejtpërdrejtë, transparent, fisnik, i dhembshur dhe zemërbardhë, trashëgonte tiparet fisnike të racës. Dhe i besoj njohjes time, intuitës time, jo hamendjeve të liga dhe dyshimeve.

#### **Sa i madh është rreziku, që ajo që ka mbetur në dosje, të jetë shumë pak në mos hiç gjë?**

Mund të kenë hequr dosjet e veta, shtetarë apo zyrtarë të lartë, por shkrimtarëve nuk ua ka hequr kush dosjet, i kanë aty. Unë besoj se prapë në dosjet e mbijetuara deri tani ka material të mjaftueshëm për të kuptuar gjëmen e madhe që komunizmi u ka bërë shqiptarëve. Kjo është më e rëndësishmja. Nëse disa emra spiunësh mbetën pa u deshifruar, kjo nuk është edhe aq e rëndësishme. Në përgjithësi, ne edhe në atë kohë i njihnim spiunët tanë, në fshat, në lagje, në qendërën e punës, në universitet, në gazetë; ruheshim prej tyre, por edhe i përçmonim. Natyrisht ka edhe prej të kamufluuarve, që nëse një ditë e merr vesh, mbetesh pa fjalë.

**Ju jeni një nga ata shkrimtarë, që padrejtësitë e sistemit komunist, i keni hequr nën lëkurë, çfarë mundet që tu thoni atyre njerëzve, që kanë vuajtur**

#### **gjatë asaj periudhe, edhe kur dëgjojnë që lëvdohet emri i Dritëro Agollit ndihen të fyer?**

Kur mendoj se sa shumë kanë vuajtur të tjerët, në burgje e kampe internimi, kur mendoj ata që u vranë pa faj, u pushkatuan pa gjyq ose me gjyq politike të montuara me shpifje e dëshmitarë të rremë, mua më vjen turp t'i përmend ato ç'kam hequr vetë nga komunizmi, ndaj dhe është hera e parë që flas publikisht për to, ndërsa miqtë e mi kanë shkruar. Por unë mendoj dhe them se nuk ishte Dritëro Agolli ai që përmbysi fatet e tyre dhe as e kishte në dorë t'i ndryshonte këto fate, pavarësisht pozicionit politik që kishte dhe pushtetit formal që i ishte dhënë. Dhe një copë shef seksioni arsimit, një injorant province, e flakte në kosh me përbuzje një rekomandim a letër porosi të tij. Me sa di unë, kur i ka ecur fjala ai ka ndërhyrë vetëm për mirë. Ndaj askush nuk ka pse të ndihet i fyer.

#### **Shqipëria ka pasur edhe shkrimtarë të tjerë, që kanë ndenjur në hije, si Federik Rreshpja, Jamarber Marko, Zef Zorba e të tjerë, pavarësisht se pena e tyre ishte e fuqishme, në rast se Shqipëria nuk do të kishte përjetuar periudhën e komunizmit, a do të ishte Dritëro Agolli shkrimtari më popullor?**

Në histori nuk mund të supozohen mundësitë, ngaqë ajo ndodhë vetëm njëherë. Historia nuk mund të eksperimentohet në laborator, për të vërtetuar të kundërtën, ose për të parë mundësitë të tjera. Kështu që nëse ne do të kishim pasur fatin të ishim vend i lirë, të bënim të njëjtën jetë si italianët, francezët a zviceranët, nuk e dimë se çfarë do të kishin bërë poetët e dënuar dhe të talentuar si Rreshpja, Zorba apo Marko dhe as se si do të ishte bërë Dritëro Agolli. Është fakt se e majta, jo vetëm diktatorët, por edhe e majta moderne i krijon ikonat e veta në letërsi dhe arte; e majta greke me Ricosin, franceze me Sartrin, turke me Nazim Himetin e të tjerë, që në fakt janë poetë dhe shkrimtarë të mëdhenj, pavarësisht orientimit politik. Kështu ndodh edhe me Hollywood-in në SHBA; shumica e artistëve të njohur janë mbështetës të Partisë Demokratike, që përfaqëson krahun liberal politik në SHBA. Dritëroi ishte një ikonë politike e të majtëve, por është një poet dhe shkrimtar i të gjithë shqiptarëve. Partia është përpjekur që edhe shkrimtarë të tjerë ti bëjë popullorë, por nuk ia doli. Dritëroi e bëri popullor artin e tij.

**Tani si e majta në pushtet, si e djathta (me termat zyrtarë po i quaj se nuk e di më se ç'janë) u rrinë larg shkrimtarëve, as duan t'ia dinë për ta. Por pjesëmarrja e shkrimtarëve në politikë, e bën vetë politikën më humane, i jep asaj fytyrë më njerëzore, jo këtë fytyrë kaqakësh që ka sot.**

#### **Dhe së fundmi, përse brezat e ardhshëm duhet që ta lexojnë Dritëroin?**

Me argumentet se përse duhet lexuar Dritëro Agolli mund të shkruash një libër të tërë. Unë po e them me një fjalë të vetme: krijimtaria e tij është një thesar i çmuar i tokës dhe i shpirtit shqiptar.

**Bisedoi Valeria Dedaj**

# BEST 10 NORTH "10 PERSONAZHET SHKODRANË TË VITIT 2016"

Për të katërtin vit radhazi Agjencia e Spektakleve "Buna 1" me president dhe producent z. Arben Mazi, organizoi në fund të janarit 2017 në Teatrin "Migjeni" të qytetit të Shkodrës mbrëmjen gala "BEST 10 NORTH 2016", për të nderuar personazhet më të spikatur publik të këtij qyteti, për kontributin e tyre në fusha të ndryshme sociale, kulturore dhe sportive.

Për të arritur në këtë natë, për disa javë me radhë ka qenë publiku që ka votuar në website buna1.net për figurat më të shquara si: shkrimtari më i mirë i vitit, piktori, aktori, sportisti, biznesmeni, politikani e të tjerë.

Risia e këtij edicioni të katërt, "BEST 10 NORTH - 2016" filloi që në hyrje të Teatrit "Migjeni" ku duke u duartrokitur nga të pranishmit, u bë parakalimi në tapetin e kuq i personazheve të kësaj mbrëmje.

Salla e Teatrit "Migjeni" me një publik të zgjedhur përjetoi me shumë emocion ndarjen e çmimeve, të organizuar jo si një ceremoni solemne, por si një spektakël që do ta bënte atë të këndshëm e impersionues.

Spektakli u hap me mrekullinë e tingujve të violinës që solli vogëlushi Juri Dajani, nxënës i klasës së dytë, performanca e të cilit u prit me duartrokitje nga të pranishmit në sallë.

Interpretimin e shkëlqyer të këtij talenti e pasuan me po kaq sukses edhe dy violiniste nga Tirana, Ajola dhe Xhanina nga grupi "Straight Girls".

Sipari i hapur prezantoi para publikut një dekor emocionues të realizuar në mënyrë artistike dhe funksionale nga skenografi i Teatrit "Migjeni" Hysni Halili, si dhe grafika nga Valmir Hysa. Në këtë platformë magjike, po aq magjike u shfaq para publikut edhe prezantuesja e kësaj mbrëmje Siçiljana Mazi, e cila vendosi që në prezantim një urë komunikimi mes publikut dhe personazheve që do të ngjiteshin në këtë skenë, për të marrë "shpërblimin" e mirënjohjes së bashkëqytetarëve, për veprimtarinë e tyre në shërbim të qytetit dhe më gjerë.

Në këtë atmosferë të ngrohtë që mbizotëronte në sallë, filloi sipas programit edhe "procedura" e dhënies së çmimeve për 10 personalitetet më të shquar të vitit 2016, të cilët u ngjiten në skenë mes duartrokitjeve dhe emocioneve, duke shprehur mirënjohjen e tyre për vlerësimin që iu bënte qyteti dhe komuniteti shkodran.

Kështu, i pari që u ftua në skenë ishte piktori më i ri Eros Dibra, i nominuar nga publiku si piktori më i mirë i vitit.

Çmimin ia dorëzoi piktorja e mirën-

johur Ermira Jahja.

Fotografi më i mirë i vitit u shpall Alban Xhakaj, i shquar për arritjet e tija, kryesisht në lëmin e fotografisë artistike dhe për ta nderuar me këtë çmim ishte zgjedhur znj. Brigela Demaj.

Vlerat e këtyre emocioneve i shtonte njëkohësisht edhe pjesëmarrja në këtë ceremoni e shumë personalitetëve që dorëzonin këto çmime, por që edhe vetë janë pjesë aktive e jetës sociale, kulturore, artistike e sportive e qytetit, të cilët shprehën konsideratat e tyre jo vetëm për fituesit, por edhe për punën e lavdërueshme të Agjencisë "Buna 1" për evidentimin dhe promovimin e tyre.

Përmes emocioneve të papërshkuara e mori fjalën shkrimtari dhe dramaturgu i shquar "Mjeshtri i Madh" Fadil Kraja i cili me mençurinë dhe mjeshturinë e fjalës së

tij tha se "Një personalitet bëhet i shquar me veprimtarinë e tij kur i kalon kufijtë e qytetit ku jeton e punon dhe sonte para jush kam nderin t'ju prezantoj mikun tim dhe të gjithë Shkodrës z. Agron Çela, duke e zhveshur atë nga veprimtaria politike dhe duke e prezantuar si një njeri që me humanizmin e tij ka qenë dhe është i denjë të shpallet si politikani më i mirë i vitit".

Në fjalën e tij deputeti i Shkodrës z. Agron Çela tha se "Kjo skenë është e shenjtë dhe unë ndjem shumë mirë, por gjithmonë shumë i emocionuar, sepse këtë çmim ma dorëzoi "Mjeshtri i Madh", prof. Fadil Kraja, nderi dhe mësuesi i madh i qytetit tonë".

Për t'i dhënë larmi e gjallëri këtij spektakli, ishin të ftuar edhe këngëtarët Lorenca Preçi, Klarisa Filipi, Klodiana Vata

dhe Anila Hoxha Gjermani, të cilat me performancat e tyre, mbajtën të ndezur atmosferën e kësaj nate.

Çmimi i radhës që u dha në këtë mbrëmje ishte shkrimtari më i mirë i vitit, të cilin e fitoi Zija Vukaj, si krijues, përkthyes dhe në mënyrë të veçantë mik e mësues i poetëve të rinj.

Këtë çmim ia dorëzoi përsëri shkrimtari i mirënjohur "Mjeshtri i Madh" Fadil Kraja.

Me duartrokitje nga të pranishmit u prit ngjitja në skenë e futbollistit të vllaznisë Ardit Krymi që solli në sallë atmosferën e këtij sporti kaq të dashur për shkodranët dhe këtë çmim ia dorëzoi po një ish futbollist, Enti Çaku, sot trajner i "Albanian Ajaks School U-19" dhe inspektor i sportit në Drejtorinë Arsimore Shkodër.

Përsëri në fushën e sportit me çmimin e radhës në këtë mbrëmje u nderua trajneri më i mirë i vitit për grup moshat, të cilin e fitoi Luan Shpuza.

Këtë çmim ia dorëzoi nënkryetari i qarkut Shkodër z. Maxhit Cungu.

Merita Smaja u shpall aktoria më e mirë e vitit "Best 10 north" e njohur jo vetëm për karrierën e gjatë në skenën e Teatrit "Migjeni", por edhe si pjesë e sukseseve të këtij teatri kohët e fundit.

Këtë çmim përmes emocioneve ia dorëzoi kolegja, sot drejtoreshë e Teatrit "Migjeni" aktoria e mirënjohur znj. Rita Gjeka.

Çmimi i radhës që u shpall në këtë mbrëmje ishte biznesmeni më i mirë i vitit që e fitoi Mark Babani dhe këtë çmim ia dorëzoi gazetari i mirënjohur i RTSH për 40 vite me radhë, Tom Therçaj.

Më pas moderatorja Siçiljana Mazi foli për organizimin para disa javëve në Tiranë, ku u ndanë çmime për fasonin më të suksesshëm në të gjithë Shqipërinë, ku pjesë e këtij aktiviteti, sukcesi ishte edhe një nga ndërmarrje e Shkodrës, "Madish SHPK", e cila u vlerësua në këtë mbrëmje me çmimin fasoni më i mirë i vitit.

Për këtë, administratorit të "Madish SHPK" z. Aleksandër Leqeja iu dhurua një buqetë e madhe me lule nga organizatorët.

Agjencia e spektakleve "Buna 1" nuk e kishte harruar detyrën e saj për të vlerësuar edhe talente të rinj të Shkodrës, ku kishte përzgjedhur këngëtarin e talentuar, Isli Ademi si





# JETA KA KUPTIMKUR PËRMBUSHË DËSHIRA POETESH

MENDIME RRETH VËLLIMIT POETIK "KAM FRIKË" AUTORES DIANA TABAKU



Nga PRELË MILANI

Diana i hipa "Pegasit" tënd të bardhë dhe udhëtova, here me ju, here vetëm si udhëtare i aventurës drejt monopateve poetike që ju na keni servirë në botimin e fundit poetik "Kam frikë".

Edhe tani që përfundova këtë udhëtim më bëhet sikur akoma nuk kam zbritur dhe jam atje mes tyre. Ky libër është një vegim jo papritur që erdhi prajshëm në bunin e poezisë shkodrane. Diana Çelepia kishte shtegtuar edhe pare horst-grabeneve të poezisë, ndërsa më vëllimin tanishëm është bërë pjesë e fryme artistike që formon imazhin dhe pasaportën e saj poetike. Guralecët shumëngjyrësh të mozaikut tuaj poetik janë zgjedhur me kujdes nga një pirl madh koralesh të ngjashme me një strukturë ngurte shkëmbore, por edhe fole e ngrohtë e gjallese në shelfin e trazuar të jete sonë. Autorja komunikon lirshëm në mënyre drejtpërdrejtë me çdo moshë dhe besoj se ka arritur dëshirën që ka çdo krijues për të qenë e pranishme dhe jo kalimtare.


"Kam fikë" është një realitet poetik, në të cilën gjendet një gërshetim racional i konceptimit poetik dhe gicilimit të emocioneve njerëzore. Poemti "Ti mundesh" përveç se është një majat e këtij vëllimi e mbartur më mire nga honet e poezisë se rimuar. Të gjitha strofat nisin me epitete krahasuese të së bukures, të mb-

ingarkesës estetikës, të cilat kanë krijuar ndjesi të mrekullueshme komunikimeve shpirtërore. Epitete "zhdjergur", "ngrehaluc", "vanitoze" e të tjera duket se peshojnë si një jehonë prej nga marrin udhë tufat e vargjeve të këtij vëllimi. Shumica e poezive kanë kutin përdorshëm të metrikës, ka një marrëdhënie vepruese me kulturën dhe traditën popullore fort ndikuese nga qyteti ku ka mbire e hell shtat autorja. Gjithsesi autorja nuk i qëndron strikt një skeme, por lëvizë lirshëm edhe hapësirën e vargut të thyer. Pjesa më madhe poezive kanë temën e njohur të afeksionit njerëzor dhe të kumteve perceptive që burojnë nga kontekstet e përndjeshme të poetes. Poezia e Dianës duket se buron spontanisht dhe rrjedhe me pas e lirshme si burimet pasi çajnë strukturat karbonitike. Autorja mban emrin e perëndeshës romake të dashurisë, nga e cila përveç huazimit të emrit i ka vjedhur edhe hirit edhe pasionin erotik. Gjithsesi Diana jonë e thjeshtë njerëzore e vdekshme i këndon dashurisë siç ja ndien shpirti me aq pathos si Safoja (poeteshë e Greqisë së lashtë). Natyra e saj pasionante, nuk mund të mbahet e ndrydhur si sythe i fjetur, por shpërthen në mënyre vokloziane në refrone lirike të tilla si "Trendafilu mëkatarë", "Një palë buzë skriviani gjeta", "Thika me dy pre-

sa", apo "Përkushtim" e të tjera. Autorja gjithashtu është nënë, mësuese, vëzh-

në mënyre të veçantë poezia kryefjalë që "Kam frikë", janë pasthirra të forta me sens të mprehtë satire që drejtohen kundër të ashtu quajturave tabu, hipokrite, të cilat kur shkopsiten nga një grua e mençur dhe pa komplekse marrin vlera të qenësishme. Te politikanët, poetet, artistët, gratë, policët dhe majtistët smira dhe xhelozia është në shkallen më të lartë mes gjithë kategorive sociale shoqërore të çdo vendi. Kjo xhelozia na bën ta shohim njeri - tjetrin me paragjykim, të nënvleftësojmë e të flasim me keqdashje. Poezia e Dianës ka aromën, shijen, vulgun e ndjenjave, ka stampën e saj. Poezia e Dianës është shoqërore e emancipuar ideja e se cilës është se jetojmë në një kohë tjetër, në një shekull tjetër në kohën e përmbysjeve dhe ndryshimeve të mëdha, që kanë krijuar hapësira dhe dimensione të tjera. Është perceptueshme, e thjeshtë e çiltër e drejtpërdrejtë e pa ngarkuar me abstraksione si shumë poezi të ashtuquajtura moderne apo postmoderne të "stërholluara" si pëlhura merimangës kur bie e ngatërrohet ndonjë pre.

Në gjithë vëllimin mbisundon bardhësia dhe filozofia e shëndetshme, se jeta ka kuptim kur përmbushë dëshira poetesh!



guese dhe luftëtare e papajtuashme ndaj plagëve dhe ligësive të vjetra e bashkëkohore. "Ndershmëri", "Shtat Pash", "Flirt njëzetekatër karatesh", dhe

◀ këngëtarë mirë i vitit.

Këtë çmim ia dorëzoi kolegja e tij Orjeta Kelaj, që vjet u nderua po me këtë çmim.

Agjencia "Buna 1" thirri para publikut shkodrane personalitete të tjera të shquara, që kontributin e tyre nuk e shtrinë në një apo dy vite, por në një karrierë të gjatë në shërbim të qytetit dhe më gjerë. Për këtë u akorduan edhe dy çmime mirënjohje.

Çmimi i mirënjohjes për rapsodin dhe lahutarin Jonuz Delaj, të cilin ia dorëzoi Kryetari i Bashkisë së Malësisë Madhe, z. Tonin Marinaj dhe Akademikut z. Ahmet Osja, të cilin ia dorëzoi moderatorja e talentuar e këtij spektakli, simpatikja Siçiljana Mazi. Këtë atmosferë ceremoniale e ngrohu dhe e gjallëroi përsëri performanca e dy violinistëve të talentuara, Ajola dhe Xhanina, të cilat interpretuan muzikë instrumentale live.

Ish basketbollisti i shquar i vllaznisë, trajner, por edhe personalitet i shquar publik z. Renato Radoja u ngjit në skenë, duke marrë bashkë me duartrokitjet edhe çmimin e karrierës, për punën e tij të palodhur dhe pasionante.

Nuk kishte si të ndodhte ndryshe. Një sportist i shpreh mirënjohjen një kolegu të tij, ish kryetari i parë i Bashkisë Shkodër dhe sot anëtar i Këshillit Bashkiak z. Filip Guraziu.

Dashamirësi i gjithë shkodranëve, humoristi i shquar Zef Deda "Mjeshtëri i Madh", me shumë emocion u ngjit në skenë për të marrë çmimin e karrierës, të cilin ia dorëzoi moderatorja e këtij spektakli Siçiljana Mazi.

Me humorin që e karakterizon ai u shpreh: "Karriera ime si humorist është e barsvlershme me jetën time, pasi gjithë këtë jetë e kam kaluar mes shkodranëve të mi në të gjitha lagjet, rrugët dhe rrugicat e qytetit ku kam lindur dhe ku jam rritur. Ndjem krenar që jam bir i këtij qyteti dhe pjesë e kësaj skene magjike".

Qershia mbi tortë ishte në mbyllje të spektaklit, kur në skenë doli për të përshëndetur të ftuarit, zëri i mrekullueshëm i këngëtares së madhe sopranoja me famë botërore Anila Hoxha Gjermani, vajza nga Bajram Curri, e cila studioi në Shkollën Artistike "Prekë Jakova" dhe që e re interpretoi edhe në skenat e qytetit tonë.

Kënga e fundit, titulluar "Malli përtej detit" e këtij spektakli e interpretuar nga kjo soprano ishte dhe urimi "natën e mirë", që ajo i dhuroi spektatorëve në mënyrë melodioze, për t'i kujtuar se në këtë skenë, nuk do të mungojnë kurrë aktivitete të tilla, që shkodranët i kanë aq shumë për zemër.

Agjencia e spektakleve "Buna 1" mbyll kështu një edicion tjetër të suksesshëm të "BEST 10 NORTH", duke premtuar që vit pas viti të sjell të tjera risi, të tjera surpriza dhe të tjera figura të shquara të këtij qyteti që nuk mungojnë kurrë.

Në këtë mbrëmje ishin të pranishëm drejtues të institucioneve vendore, deputet, njerëz të shquar të artit, kulturës, sportit, biznesit etj. të cilët e ndjenin veten të privilegjuar që patën nderin t'u dorëzonin çmimet 10 personazheve më të shquar të vitit, që këtë natë ishin nominuar si më të mirë.

Suksesi i kësaj mbrëmje gala që ka jehonë edhe sot e kësaj dite meriton edhe lavdërimet e përkrahësve dhe sponsorëve, dashamirës të mbarëvajtjes së jetës social kulturore dhe ekonomike të qytetit.

Një falënderim shumë i madh shkon për kompaninë "Hako SHPK", e cila ofroi mbështetjen e saj për këtë spektakël.

Ishte një privilegj i madh që këtë vit të merrte pjesë si sponsor një nga kompanitë më të fuqishme në Shqipëri, urojmë që ky bashkëpunim të mos jetë i fundit.

Një falënderim tjetër shkon për mbështetjen "Madish SHPK", Gomisteri "Sela", Art Decor Print & Design "Terroti" si dhe Bar Restorant Bexhisteni, pronë e familjes së Astrit Meshnunit, që gjithmonë ka ofruar mbështetjen në shenjë respekti për 10 personazhet e vitit. Gjithashtu u falënderuan edhe Firma "Berttoni" si dhe Kancelari "Mazi".

Organizatorët falënderuan Radio Televizionin Shqiptar, si dhe të gjithë televizionet lokale, si TV1 Channel, Star +, TV Rozafa dhe TV Kopliku, për pasqyrimin e këtij aktiviteti.

Ky ishte edicioni i katërt dhe si i tillë, ai për çdo vit ka fituar rritje, duke premtuar kështu që nga viti në vit ai do të bëhet një traditë që vetëm një qytet si Shkodra mund ta realizojë.

Nga RAMAZAN ÇEKA

# Reformë në drejtësi apo drejtësi tranzitore në Shqipëri?



Në përpjekje për të qenë pjesë e Bashkimit Evropian, shteti ynë, aktorët përkatës dhe shoqëria shqiptare po përpiqet në dukje t'i adresohet të gjitha çështjeve të drejtave të njeriut duke përfshirë të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore nëpërmjet thirrjes sociale për të bërë reformë në drejtësi.

Duke marrë shkas nga kjo dhe e shtyrë nga pjesëmarrja në një seminar të titulluar "Dosjet e pezulluara kundrejt reformës në drejtësi", të organizuar nga Shoqata "Youth Development Group", Tiranë në të cilën ishin të pranishëm studentë të Juridikut dhe aktivistë social, u nxitua për të shkruar këtë artikull: Vërtet sa dosje të pezulluara janë aktualisht nëpër Gjykatat tona, të cilat lënë pezull jetët njerëzore?? Përse lihen të pezulluara?

Për të diskutuar në lidhje me një çështje të tillë e ftuar ishte gazetaria Zj. Nikoleta Kovaçi, e cila vuri në dukje se shteti ynë është në një kolaps: duket sikur reforma në drejtësi do e zgjidhë problemin tonë, por në të vërtetë reforma ka nevojë për njerëz, për ne që e duam drejtësinë dhe jo ti besohet një pale partiake ku dominon falsiteti dhe korrupsioni. Për të bërë një reformë të mirëfilltë nevojitet edhe kohë fizike që lë kohë për menaxhimin e plotë të procesit.

Për më tej vuri në dukje se për të pasur tamam drejtësi, ndër të tjera media duhet të jetë e lirë pasi jo rrallë ndodh që kur gazetari futet në skuta të errëta për të zbuluar se çfarë është duke ndodhur dhe si ka ndodhur, përfundon keq ose kalon rreziqe me jetën.

Më konkretisht, Zj. Kovaçi i referua një dosje të pezulluar ku një djalë është varrosur i gjallë dhe ka qëndruar i gjallë për 48 orë në Mat: Çështja është në Gjykatën e Apelit, ndërsa personat që janë dënua vijnë nga 10 deri në 17 vite, ndërsa familja nuk ka ku të ankohet duke përmendur faktin ndër të tjera që ishte një djalë i vetëm. Në këto raste a mund të flitet për mundësi amnistie??

Nga këndvështrimi psikosocial, dështrimi për të realizuar të drejtat humane në

aspektin ekonomik, social dhe kulturor si dhe dhunimi ndaj këtyre të drejtave mund të jenë dhe zakonisht janë pjesë e rrënjës që shkakton konfliktin, fenomenet e errëta sociale dhe represionin procesin e të jetuarit. Për më shumë, veprime të tilla kanë ndikim mbi ato shtresa që janë më të prekshme sikur në rastin e mësipërm. Le të pyesim sërish, sa çështje jetësore mbeten të pazgjidhura duke lënë pezull shumë aspekte jetësore? Vërtet për ti thënë ndal ndodhive të tilla në dukje të parë nevojitet një reformim në drejtësi. Por a mund të kemi reformë në drejtësi pa kaluar me sukses në fillim drejtësinë tranzitore? Le të bëjmë një krahasim të të dyjave:

Së pari, rregulli i programit të reformës në ligj është një fenomen më global i mbështetur nga një numër agjencish dhe vendesh, dhe racionalizohet në bazë të zhvillimit ekonomik, demokratik dhe paqes. Qasja e tij ndaj çështjeve të reformës dhe rindërtimit të një sistemi ligjor është në tërësi plot nuanca, sidomos për një vend post tranzitor sikur është vendi ynë. Prandaj për të bërë një reformë të tillë nevojitet të merret parasysh zhvillimi ekonomik, demokratizimi, reduktimi i varfërisë dhe ndërtimi i paqes.

iu adresuar padrejtësive të bëra në të kaluarën që do të prokurojnë një të ardhme të barabartë. Kjo pasi duhet punë për të arritur dhe shkuar përtej krimeve dhe abuzimeve të kryera gjatë konflikteve që kanë çuar në tranzicion dhe duhet ti adresohet dhunimit të të drejtave humane dhe shkaqeve që kanë kontribuar në to.

Po ti referohemi kësaj drejtësie sërish kemi sfidën që të mund të ngremë pyetjet të tilla, si në vijim:

(a) Cili është mekanizmi potencial i drejtësisë tranzitore për t'iu adresuar çështjeve jetike si fillim?

(b) A janë këto mekanizma funksionalë të përshtatshëm për t'ia dalë mbanë me to?

(c) Si mund të lidhet më së miri drejtësia tranzitore me të drejtat ekonomike, shëndetësore sociale dhe kulturore?

(d) Çfarë parimesh duhet të udhëheqë përfshirja e drejtave ekonomike, shëndetësore, sociale dhe kulturore në proceset e drejtësisë tranzitore?

(e) Cilat pengesa duhen kaluar?

Duke pasur parasysh që të drejtat ekonomike, shëndetësore, sociale dhe kulturore janë pjesë e kornizës ligjore të të drejtave universale humane, në të cilën

ndalim pak duke cituar Prof. Asoc. Dr. Jordan Daci, i ftuari kyç në këtë seminar, i cili theksoi që duhet të jemi të përgatitur si shoqëri për të bërë reformën në drejtësi pasi vetë shoqëria jonë nuk është në gjendje të prodhojë një standard të ri. Përveç kësaj duhet të kemi kujdes nga drejtësia represive. Çfarë do të thotë kjo? Do të thotë që thjesht të jemi në rregull me reformën në drejtësi.....

Prandaj, sërish i rikthehem drejtësisë tranzitore... A do ishte e përshtatshme që vendi ynë të fillojë me këtë? Në thelb, drejtësia është një përpjekje e përjetshme për tu dhënë të gjithëve atë që u takon... Prandaj për këtë, hyn koncepti i realizimit progresiv që përshkruan një aspekt qendror të obligimeve të shtetit në lidhje me këto drejta sipas të drejtave ndërkombëtare humane. Ndërkohë një që realizimi i plotë i këtyre të drejtave nuk mund të arrihet menjëherë dhe kërkon kohë në mënyrë që të gjithë aktorët të marrin masat e nevojshme drejt realizimit të plotë të burimeve të mundshme. Pra, le të besojmë që jemi duke u përgatitur, por nevojitet vetëm pak kohë më shumë.....

Edhe pse tashmë ka një fokus në rritje mbi reformën në drejtësi, ka pak udhëzime mbi si ta qasim një rregull të reformës në drejtësi, dhe si strategjitë e adoptuara të ndryshojnë në përshtatje me vendin tonë. Kjo pasi sipas Mani (2002), janë dy kategori në kontekstin e një vendi në zhvillim: kategoria I korrupsioni dhe mosfunksionalizmi, kategoria II: e paligjshme, por funksionale. Të gjitha këto përmeshin atë që në një masë ekstreme paraqesin karakteristika të një paqeje akute, një mungesë të kapaciteteve profesionale dhe burokratike, një kulturë inflamtoare dhe të dhunshme të kulturës politike dhe një shoqëri të shpërndarë dhe shumë të traumatizuar nga çfarë ndodh.

Në mbyllje të këtij artikulli, dëshiroj të theksoj një ftesë të hapur për të gjithë, me qëllim që të fillojmë të punojmë si agjentë të ndryshimit, ne duhet së pari të jemi në gjendje të kemi vizionin e një shoqërie bazuar në parime të barazisë dhe drejtësisë sociale për të gjithë. Është në mënyrë kritike e rëndësishme të fillojmë për të krijuar hapësira për drejtësinë tranzitore apo reformën në drejtësi që të gjithë njerëzit të gjejnë zërin e tyre, të ëndërrojnë dhe të krijojnë një vizion, që është i vërtetë për ta dhe bazohet në një dosje të hapur/ transparente të të drejtave universale humane.

Përgatitur nga: **Suela NDOJA**



Referuar këtyre të fundit, secili prej nesh është i ftuar për të bërë një analizë vetjake, sa u është zgjidhur problemi i papunësisë, sa demokratë jemi në realitet në trajtimin dhe ndërhyrjen e çështjeve jetike, në mbështetjen e shtresave të marginalizuara dhe sa po reduktohen konfliktet familjare, sociale dhe politike?

Së dyti, drejtësia tranzitore ka ambicien pozitive për të ndihmuar shoqëritë e shtypura dhe për ti bërë ato të lira duke

të gjitha të drejtat janë universale, të ndërvarura dhe të ndërlidhura, atëherë a mund të themi që drejtësia tranzitore mund të jetë një pjesë kryesore e reformës në drejtësi? Kjo, pasi këto të drejta ndërtojnë kushtet minimale të kërkuara për njerëzit që të jetojnë në një mënyrë dinjitoze, për të siguruar lirinë nga frika dhe dëshira, dhe përmirësim të vjueshëm të këtyre kushteve.

Lidhur me këtë të fundit, dëshiroj të

të dijmë \*\*\* të dijmë \*\*\* të dijmë \*\*\* të dijmë \*\*\* të dijmë \*\*\* të dijmë \*\*\* të dijmë

# 10 problemet më të mëdha, që do të përcaktojnë fatin e planetit tonë



Ekonomisti i Bankës Botërore, Jean Francois Rischard, argumenton se komuniteti ndërkombëtar ende jeton në kohë shumë të vështira. Mundësia jonë për tu përballur dhe për të hasur me një sërë problemesh të komplikuar sociale dhe ekonomike është më e madhe në këtë mijëvjeçar, se ç'ka qenë gjatë këtyre viteve. Zhvillimet teknologjike, rritja ekonomike dhe evolucioni kulturor – të gjitha karakteristikat të globalizmit – ka zhvilluar aftësinë tonë për të zgjidhur shumë nga “të këqijta sociale” që vazhdojnë të ekzistojnë. Identifikimi i mjeteve të duhura për tu përballur me problemet është element shumë i rëndësishëm, por hapi i parë që duhet ndërmarrë është të identifikuarit dhe të kuptuarit e problemeve më të mëdha dhe se cilat prej tyre kanë karakter global. Nëse këto probleme konsiderohen globale, atëherë, në një botë tërësisht të ndërvarur, ne duhet të aplikojmë metoda që do të përdoren nga të gjitha kombet për të zgjidhur këto probleme. Dy dekadat e ardhshme do të jenë të një rëndësie mjaft të madhe për planetin tonë. Mënyra se si do të zgjidhen këto probleme do të përcaktojë fatin e planetit dhe të të gjitha gjeneratave. Më poshtë renditen dhjetë problemet më urgjente me të cilat bota përballlet sot.

## 1. Kolapsi global ekonomik

Sistemi global financiar sot është më i ndërlikuar dhe bashkëveprues se ndonjëherë tjetër, dhe një krizë në një nga bankat më kryesore apo në një nga vendet më të rëndësishme në botë, mund të përhapet me shpejtësinë e dritës. Çdokush që në ditët e sotme flet për qëndrueshmëri të sistemit ekonomik botëror, nuk ka informacionin e mjaftueshëm për ta thënë këtë. Nëse shihen, të paktën depozitat bankare botërore, është konkluduar se sasia totale e borxhit të marrë nga qytetarët është shumë më e madhe se sasia totale e parave në qarkullim. Vende të ndryshme të botës, në kohë të ndryshme, janë përballur me krizën ekonomike të vendit. Kjo nuk ka qenë aspak e lehtë, dhe pritet që e njëjta gjë të vlejë dhe për krizën aktuale ekonomike me të cilën po përballlemi.

## 2. Terrorizmi

Terrorizmi është problemi aktual glob-

al që vë po vë në rrezik jetën e çdo personi në tokë. Qëllimi kryesor dhe parësor i çdo qeverie duhet të jetë inkurajimi dhe nxitja e individëve që të bashkojnë forcat e tyre ndaj terrorizmit dhe ta fitojnë luftën ndaj tij përmes përpjekjeve të përbashkëta. Qeveritë duhet të njohin rëndësinë madhore të këtij problemi dhe si rrjedhojë, aktiviteti politik i saj duhet të bazohet në këtë konsideratë madhore. Për të zgjidhur problemin madhor të terrorizmit, ne duhet të zbulojmë origjinën e tij, të analizojmë veprimet që kanë ndërmarrë kombet kundër tij, dhe qëndrimin social të shoqërive ndaj këtij fenomeni. Politikatat aktuale globale nuk kanë qenë në gjendje ta ndalojnë përhapjen e terrorizmit dhe kanë bërë një punë të pamjaftueshme për ta minimizuar atë. Njohja e konceptit të terrorizmit do të ishte e një rëndësie mjaft të madhe pasi terrorizmi shpeshherë ngatërrohet dhe lidhet vetëm me vende dhe popuj të caktuar. Ndaj është e nevojshme që bota të marrë masa të forta për tu përballur me këtë problem.

## 3. Prodhimi i armëve të shkatërrimit në masë

Prodhimi i armëve të shkatërrimit në masë (armët bërthamore, kimike dhe biologjike) dhe teknologjia e përdorur për prodhimin e tyre është sot një ndër problemet më madhore që kërcënon paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Përdorimi i këtyre armëve kundërshton dhe bie ndesh me të gjitha ligjet ndërkombëtare, dhe veçanërisht ato humanitare dhe çështjet që ato mbrojnë. Kryetarët e shteteve dhe qeveritë kombëtare që morën pjesë në Samitin në Çikago në Maj të 2012s, argumentuan se “prodhimi i armëve të shkatërrimit në masë kërcënon dhe vë në rrezik vizionin tonë të përbashkët për të krijuar kushtet e nevojshme për një botë pa armë bërthamore, në përputhje me qëllimet e Aktit Kundër Prodhimit të Armëve Bërthamore (NPT).

## 4. Ndryshimet klimaterike

Ndryshimet klimaterike me të cilat po përballlemi sot në shek XXI, është një ndër problemet më urgjente me të cilat përballlet bota. Toka po ngrohet, dhe ekziston një konsensus i madh ndërmjet shkencëtarëve që kjo realisht po ndodh dhe është e shkaktuar nga njerëzit. Me rritjen e përmasave të ngrohjes globale dhe me zhdukjen e specieve dhe habitateve të tyre, aftësia e ekosistemeve për të përshtatur natyrshëm është zvogëluar jashtëzakonisht shumë. Shumë studiues tashmë kanë pranuar dhe rënë dakord se ndryshimet klimaterike janë një ndër problemet kryesore dhe një ndër kërcënimet kryesore me të cilat po përballlet planeti. Në vitet e fundit është regjistruar një rritje e madhe e temperaturave në rajone

të ndryshme të botës, dhe ndryshime ekstreme në kushtet klimaterike, ku përmenden uraganet dhe tërmetet që kanë ndodhur gjatë këtyre viteve të fundit.

## 5. Mbipopullimi

Numri i popullsisë në botë shumë shpejt do të arrijë nivele të paparashikueshme dhe të paprecedentë, gjë e cila do të shoqërohet me shkurtime dhe mungesë burimesh për të përballuar jetën. Rritja duhet të ndalohet ose të paktën të limitohet, në mënyrë që të mund të shmangët kjo katastrofë. Shumë nga problemet mjedisore, sociale dhe ekonomike janë krijuar ose janë rritur për shkak të problemit të mbipopullimit. Në mënyrë që të stabilizohet numri i popullsisë, jo vetëm në zonat e botës së tretë, por dhe në zonat e industrializuara, bota duhet të bashkëpunojë që të arrijë rritjen zero të popullsisë. Toka nuk zotëron burime të mjaftueshme që të përballojë rritjen e madhe dhe të pakontrollueshme të popullsisë. Shumë njerëz sot po vdesin për shkak të kequshqyerjes dhe problemeve që lidhen me të. Ndaj nevoja për të kontrolluar rritjen e popullsisë merr një rëndësi madhore.

## 6. Mungesa e ujit

Një tjetër burim, dhe në një masë mjaft të madhe një problem botëror, i lidhur ngushtësisht dhe me rritjen e popullsisë, është uji. Furnizimi me ujë të pijshëm është i limituar. Thatësira dhe mungesa e zgjatur e ujit në Kaliforni është një shembull i qartë i këtij problemi. Shpesh kanë lindur probleme dhe konflikte ndërmjet fermerëve, njësisë bashkiake, ambientalistëve dhe të tjerëve rreth të drejtave mbi ujin. Kohët e fundit ka patur debate dhe konflikte mes ambientalistëve dhe qeverisë së Los Anxhelos, lidhur me problemin e ujit: filtrimi i ujit nga liqeni Mono në bazën ujore të LA. Ky konflikt i lindur tregon në një masë të madhe problemet që lindin si pasojë e mungesës së ujit, ku furnizimi me ujë të pastër dhe të pijshëm është shumë i kushtueshëm.

## 7. Varfëria

Në sondazhet e realizuara këtë vit, varfëria është cilësuar dhe renditur si një nga problemet më serioze me të cilin po përballlet bota në ditët e sotme – e lidhur ngushtësisht me kolapsin ekonomik – përfshi këtu dhe vende të tilla si Mbretëria e Bashkuar, ShBA dhe vende të tjera, që konsiderohen si vende të fuqishme ekonomike. Është argumentuar, në bazë të gjetjeve të këtyre sondazheve, se rritja e kostove ushqimore dhe të energjisë ishte një nga arsytet më serioze të uljes së nivelit ekonomik dhe rrjedhimisht të rritjes së varfërisë. Varfëria në ditët e sotme konsiston në atë që miliona njerëz sot nuk kanë ku të jetojnë; jetojnë nën nivelin minimal

të jetesës; kanë pamjaftueshmëri në konsum ushqimor; vuajnë nga kequshqyerja; nuk kanë akses ndaj shërbimeve shëndetësore, për të siguruar ujë të pijshëm. Megjithëse Bota ka burimet dhe aftësitë e mjaftueshme dhe të nevojshme për të zhdukur varfërinë, që përbën vetëm 1 % të të ardhurave botërore, ende njerëzit përballen me varfëri ekstreme dhe pasojat që vijnë si rezultat i saj.

## 8. Speciet në zhdukje

Në ditët e sotme, aktivitetet njerëzore përbëjnë shqetësim për shkak të zhdukjes masive të specieve të ndryshme – një pasojë e cila nuk mund të kuptohet tërësisht. Rritja e temperaturës në oqeanë redukton aftësinë e planktoneve për tu riprodhuar, dhe si rrjedhojë duke dëmtuar dhe vënë në rrezik e gjithë ekosistemin oqeanik. Për më tepër, praktikatat moderne agrikulurore dëmtojnë hapësirat e punueshme të tokës përmes ujërave dhe erozionit, dhe gjatë këtij procesi shkatërron mikro ekosistemi i mahnitshëm të cilit i janë dashur miliona vite për tu formuar dhe për t'i dhënë jetë jetës në tokë.

## 9. Impakti potencial i meteorëve

Në shkurt të 2013-s, njerëzit që shkuan të punonin në qytetin Chelyabinsk dëgjuan se si ishte zhurma e një shpërthimi dhe panë një ndriçim të shndritshëm dhe më pas ndjenë valën e tronditjes në këtë qytet industrial, vetëm 1500 km në lindje të Moskës. “Topi i zjarrit” që udhëtonte me një shpejtësi prej 30km/sek, sipas agjencisë hapësinore Ruse, shpërtheu në horizont, duke lënë shenja të mëdha të bardha që mund të shiheshin deri në 200 km larg. U ndezën mijëra alarme makinash, mijëra xhama dritarësh u thyen dhe rrjetet e kompanive telefonike pësuan dëme. Ministri i Brendshëm i Rusisë është shprehur se shpërthimi i meteorit, një ndodhi mjaft e rrallë, ka rritur shqetësimet rreth ardhjes së fundit të botës.

## 10. Nafta dhe gazi

Nafta si lëndë djegëse dhe bazë për shumë produkte është një problem që shkon përtej ngrohjes globale. Edhe po të mos kishte ngrohje globale, nafta do të ishte problem, sepse është shumë e kushtueshme dhe ka nxitur lindjen e luftërave të shumta. Konflikte të shumta kanë lindur mes shteteve të ndryshme me qëllim marrjen në zotërim dhe kontrollin e zonave të pasura në këto lëndë. Rezerva të konsiderueshme naftë dhe gazi gjenden në det, në pjesë të ndryshme të botës. Megjithatë, kërkimet, shpimet dhe transporti i këtyre lëndëve mund të dëmtojë rëndë zonat ujore dhe speciet që jetojnë në këto zona.

Mblodhi Ndue Sanaj

\*\*\* LAJME \*\*\* LAJME \*\*\* LAJME \*\*\* LAJME \*\*\* LAJME \*\*\* LAJME \*\*\*



## NDËRMARRJA MADISH SHPK NMDEROHET ME ÇMIMIN "BLETA E ARTË"


Me 30 dhjetor 2016, në Tiranë organizohet ndarja e çmimit për fasonin më të suksesshëm, me çmimin "Bleta e Arte", për vitin 2016, në Republikën e Shqipërisë. Çmimi "Bleta e Arte" i jepet Ndërmarrjes "MADSH –shpk", në Shkodër. Ky çmim, "Bleta e Arte", i dorëzohet zotit Gjergj Leqja, i cili pas marrjes së çmimit, mban dhe fjalën e rastit.

Të gjithë shkodranet janë të gëzuar për suksesin e kësaj ndërmarrje, por në veçanti anëtarët e Shoqatës atdhetare "Dukagjini".

Edhe në veprimtarinë e zhvilluar në teatrin "Migjeni", për "10 personazhet shkodrane në vitin 2016", administratorit të saj, zotit Aleksandër Leqejza, për kete sukses, iu dhurua një buqete e madhe me lule, nga organizatorët e kësaj veprimtarie.



## PRESIDENTI I REPUBLIKËS NDERON ARTISTËT



Presidenti i Republikës, Shkelqesia e tij, z. Bujar Nishani, në një ceremoninë solemne të zhvilluar, me datën 24 shkurt 2017, në Institucionin e Presidentit të Republikës, ku ishin të pranishëm artistë dhe aktorë, Ministria e Kulturës Mirela Kumbaro, regjisorë e skenaristë, familjarë dhe personalitete të artit e kulturës, vlerësoi aktorë të mëdhenj të skenës teatrore dhe kinematografisë shqiptare me **Urdhërin "Gjergj Kastrioti Skënderbeu"**, në mes tyre:



Urdhëri Gjergj Kastrioti - Skenderbeu

**Ndrek Lucën** (pas vdekjes), me motivacion: *"Me mirënjohje për një artist të lindur e gjenial, i cili me interpretimet e tij të shumta aq të vlerësuara nga artdashësit tanë, ka lënë gjurmë të paharrueshme në artin skenik e kinematografik modern shqiptar"*



**Tinka Kurtin**, me motivacion: *"Me vlerësim të merituar shtetëror për interpretimet e saj të përkryera e mallëngjyese, duke u shndërruar prej disa dekadash me radhë në njërin prej aktoreve më të adhuruar e mbresëlënëse të filmit shqiptar që nga filmi i parë 'Tana' e deri në qindra role të paharrueshme nëpër skenat tona teatrore"*.

Korrespondenti i gazetës Dukagjini

### REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi Botimin:

**AV. ANTON KOSTERI**

Kryetar i degës së Shoqatës Atdhetare  
Dukagjini, Shkodër

